



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

UDHËZIME PËR MODIFIKIMET DHE PËRSHTATJET
E NEVOJSHME PËR ZHVILLIMIN E QASJES NË
**PROGRAMET DHE KUALIFIKIMET E ARSIMIT DHE
AFTËSIMIT PROFESIONAL PËR NXËNËSIT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA APO ME NEVOJA TJERA TË VEÇANTA**



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

PRISHTINË, 2011

EU KOSVET V

Zhvillimi i Sigurimit të Cilësisë, Akreditimit dhe Zhvillimi i AKK & KKK në Kosovë

Nr. i Projektit: 2009/216-809

Ky publikim është hartuar me përkrahjen e Bashkësisë Evropiane.
Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e kontraktorit PEM GmbH dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i pasqyrojë pikëpamjet e Bashkësisë Evropiane.

PËRMBAJTJA

Pjesa 1 Arsyeshmëria për ndryshime dhe zhvillim të programeve dhe kualifikimeve të arsimit profesional për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta	6
Situata aktuale	6
Aftësitë e kufizuara apo vështirësitë në mësim dhe ndikimi i tyre në mësim nxënie	7
Pjesa 2 Zhvillimi i politikës dhe implementimi i strategjisë për aftësimin profesional dhe kualifikimet për nxënësit me aftësi të kufizuara apo vështirësi në mësim	7
Zhvillimi i politikës dhe strategjisë	11
Implementimi i strategjisë	11
Çka duhet mësuar	12
Si do të mësohet	12
Kush do të zhvilloj mësimdhënjën	13
Si do të vlerësohet suksesi dhe kualifikimet e dhëna	14
Resurset	14
Shtojca 1	15
Qëllimi i përgjithshëm	15
Seksioni 1. Hyrje	17
Seksioni 2. Formulimi i problemit	19
Seksioni 3. Racionalja	19
Seksioni 4. Principet e politikës	20
Seksioni 5. Çështjet kyçe dhe synimet specifike të politikës për përfshirje të suksesshme të Nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta në programet e aap	20
Udhëzime për Implementim	27
Pakoja e veglave për modifikime në mësimdhënie dhe mësimnxënie, modifikimet në vlerësim për tu përshtatur nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta	28
Seksioni 1 Ofrimi i qasjes në arsimin dhe aftësimin profesional për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta apërmes modifikimeve në mësimdhënie dhe mësimnxënie	29
Seksioni 2 Veglat për adaptimin e vlerësimit për përshtatjen e kandidatëve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta	37

PJESA 1: ARSYESHMËRIA PËR NDRYSHIME DHE ZHVILLIM TË PROGRAMEVE DHE KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA APO ME NEVOJA TJERA TË VEÇANTA

SITUATA AKTUALE

Fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta janë në mënyrë të rreptë të përfaqësuar përmes sistemit arsimor në Kosovë dhe aq më shumë të nën përfaqësuar në arsimin dhe aftësimin profesional.¹

Paragrafi 6.3 i Planit të Veprimit për aftësi të kufizuara për Republikën e Kosovës 2009 – 2011 përcakton një numër ambicioz të objektivave dhe aktiviteteve për zhvillimin e një sistemi me përfshirje me të madhe arsimore. Aktivitetet përbëhen nga formulimet e përgjithshme se çka duhet bërë.

Arsimi dhe Aftësimi profesional nuk është përfshirë në objektiva apo aktivitete.

Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm i vitit 2002 pohon nevojën për një sistem të detyrueshëm me shkollat fillore dhe të mesme ne të cilat duhet të kenë qasje të gjithë. Vazhdon të pohohet se asnjë fëmijë nuk duhet ti refuzohet e drejta për arsim.

Në pajtueshmëri me legjislacionin e tanishëm i cili bën arsimin e mesëm të lartë të detyrueshëm, duhet të zhvillohet një politikë kombëtare dhe strategji e shëndoshë për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin profesional te të rinjve me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim nxënie.

Synimi tyre do të jetë të sigurojnë që të rinjtë të kenë qasje në arsimim dhe aftësim të përshtatshëm dhe në kualifikime relevante të cilat ju japin atyre shkathtësitë për të gjetur dhe mbajtur punën. Pa udhëzime strategjike të cilat sigurojnë koordinimin të gjitha iniciativave kërkesat ligjore nuk do të përmbushen në mënyrë koherente. Zhvillimet do të jenë të copëtuara dhe do të mbështeten në zotimet e individëve apo grupeve për të implementuar ndryshimet. Zhvillimet e tilla mund të përsëriten apo mund të jenë në kundërshtim me qasjen e tyre.

Momentalisht ekzistojnë pesë shkolla speciale / qendrat e resurseve për të gjitha moshat në tërë Kosovën të cilat kanë ofruar arsim dhe aftësimin profesional për 1074 nxënës dhe të rinj në vitin shkollor 2010 – 2011. Këto janë: Shkolla Xheladin Deda për studentët me vështirësi në të pamur në Pejë, Shkolla Nënë Tereza për nxënësit me vështirësi në të dëgjuar në Prizren, dhe tri shkolla me vështirësi intelektuale - Lef Nosi në Prizren, Përparimi në Prishtinë dhe Nënë Tereza në Mitrovicë.

Numri i përgjithshëm i nxënësve që kanë marrë disa forma të arsimit dhe aftësimin profesional në këto pesë shkolla është 116. Cilësia e arsimit profesional të ofruar ende nuk është në nivelin e duhur. Po ashtu ekzistojnë klasë për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat

¹ Raport tre mujor për modifikimin e moduleve për fëmijë me aftësi të kufizuara në mësim nxënie dhe SEN fëmijët. Gazmend Tahiraj. Kosvet V, Ekspert Afatshkurtër për Sigurim Cilësie dhe përfshirje, Korrik 2011.

² Modulet ekzistuese dhe numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që vijojnë shkollat speciale – Qendrat e resurseve. Gazmend Tahiraj. Kosvet V, Ekspert Aftashkurtër për Sigurim Cilësie dhe përfshirje,

³ Statistikat e arsimit në Kosove 2010-2011

e rregullta por këto nuk janë të lidhura me qasjen në programet e AAP-së dhe shumë fëmijë braktisin shkollën gjatë apo në fund të fazës fillore.

Nuk ekziston asnjë ofrues për fëmijët dhe të rinj me aftësi të kufizuara fizike, por sipas statistikave 2 të ofruara nga Njësi për Arsim Special në MASHT nga 1074 nxënësit që kanë vijuar mësimin në shkollat speciale në vitin shkollor 2010-2011, 38 prej tyre kanë qenë me aftësi të kufizuara fizike, të gjithë në fazën fillore të arsimit. Nuk dihet se a kanë këta fëmijë aftësi të kufizuara shtesë. Ekziston një supozim i pa vërtetuar në lidhje me faktin se shumë nxënës vijojnë mësimin në shkollat e përgjithshme por nuk ekzistojnë të dhëna statistikore në dispozicion.

Një numër i panjohur i nxënësve me aftësi të kufizuara apo me aftësi tjera të kufizuara ose me vështirësi në mësim nxënie vijojnë mësimin në shkollat e rregullta të APP-së. Në punëtoritë regjionale për vetë vlerësim të zhvilluara nga KOSVET 5 shumë drejtor shkollash të AAP-së theksuan se kanë nxënës me aftësi të kufizuara në shkollat e tyre por atyre nuk ju ofrohet ndonjë mbështetje. Mendimi i përgjithshëm i shprehur në këto diskutime ishte se ata nuk mund të ofrojnë arsim të duhur për këta nxënës sepse nuk ekziston infrastruktura dhe stafi i trajnuar për të punuar me këta nxënës.

Një numër shtesë i fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara nuk kanë vijuar asnjëherë mësimin në shkollë apo nuk kanë vijuar mësimin e rregullt dhe kanë

braktisur arsimin gjatë fazës fillore, kështu që nuk kanë qasje në kualifikime profesionale.

Për të filluar adresimin e kësaj situatë është e nevojshme të vepohet si në vijim:

Një politikë e fortë e cila përcakton bazën se si do të funksionoj sistemi në drejtim të zhvillimit të arsimit dhe aftësimin të duhur dhe kualifikimeve relevante për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta

Një strategji i qartë, praktike dhe të fuqishme për implementimin e kësaj politike në tërë vendin, e cila do të udhëheq dhe koordinon të gjitha iniciativat qeveritare dhe të udhëhequra nga donatorët.

Mekanizmat e vendosur për vlerësimin e strategjisë implementuese në shkolla, nivele lokale dhe nivele kombëtare përmes procesit të vetë vlerësimit dhe përmes vlerësimeve dhe raporteve nga inspektorati.

Procedurat e vendosura të sigurimit të cilësisë për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit dhe aftësimin të përshtatshëm dhe kualifikimeve relevante për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta, përfshirë regjistrimin, mbajtjen dhe normat e suksesit në arritjen e kualifikimit dhe suksesit në tregun e punës.

AFTËSITË E KUFIZUARA APO VËSHTIRËSITË NË MËSIM DHE NDIKIMI I TYRE NË MËSIM NXËNIE

Ky seksion paraqet disa çështje që duhen marrë parasysh gjatë zhvillimit të politikës, strategjisë dhe ofrimit për studentët me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta të cilat ndikojnë në mësim nxënie dhe performacën e tyre. Udhëzimi mbi mënyrat specifike për adresimin e nevojave specifike është dhënë në Pakon e veglave (Seksioni 3A i këtij dokumenti). Pasi që arsimi i lartë i mesëm është bërë i detyrueshëm secili mësimdhënës ka gjasa të ndeshet me nxënësit me

problemet e paraqitura më poshtë – me shpeshtësi siç janë vështirësitë në mësim nxënie dhe disa me të rralla siç janë verbërimi apo aftësi të kufizuara të ndryshme fizike.

Një person është me aftësi të kufizuara nëse ka vështirësi fizike apo mendore i cili ka efekt qenësor dhe afatgjatë në aftësitë e tyre për të kryer aktivitetet e përditshme si janë: ushqimi, pastrimi, ecja, blerja apo të

shtruarit e pyetjeve për të marrë informacione dhe të jenë në gjendje të kuptojnë përgjigjet.

Nevoja tjera të veçanta mund të lindin nga vështirësitë mbi mesataren për mësimnxënie, mungesa e aftësive në të kuptuarit e gjuhës së udhëzimeve, vështirësi specifike në radhitjen dhe orientimin e shkronjave, fjalëve dhe numrave (disleksia), kushteve afatgjate shëndetësore apo të shëndetit mendor, apo rrethana tjera të cilat kanë ndikim në mësim nxënie por nuk janë mjaft të rrepta për të pasur ndikim të rëndësishëm në aftësitë individuale për të kryer aktivitetet e përditshme individuale.

Personat me aftësi të kufizuara janë individë dhe edhe pse personat me aftësi të ngjashme të kufizuara apo me aftësi tjera të veçanta kanë disa vështirësi dhe nevoja të përbashkëta çështjet e cekura më poshtë sa i përket grupeve të ndryshme të personave nuk duhet të kenë kuptimin e ndryshëm me grupet e individëve me shkathtësitë dhe nevojat e mundshme tyre individuale për modifikim dhe përshtatje brenda sistemit të AAP-së. Shumë fëmijë, të rinj dhe të rritur kanë vështirësi në mësim nxënie me të cilat ata luftojnë me disa apo të gjitha aspektet e mësim nxënies së përkohshme apo të përhershme. Disa nga ta janë thjeshtë të ngadalshëm në mësim nxënie apo kanë kapacitete me të ulëta për progres sesa shokët e tyre. Disa mund të jenë dislektik dhe kanë vështirësi të veçanta në lexim dhe shkrim dhe janë brenda mesatares ose mbi mesataren të aftësive intelektuale. Kjo do të demonstron në kuptueshmërinë dhe aftësitë e tyre për përgjigje në pyetjet gojore. Të tjerët mund të kenë kushte të tjera afat shkurtra dhe afat gjata shëndetësore apo të shëndetit mendor të cilat do të ndikojnë në pjesëmarrjen e tyre, aftësitë e tyre për koncentrim apo qëndrueshmëria e tyre për përballuar mësimin gjatë tërë ditës. Edhe pse të tjerët nuk flasin apo kuptojnë gjuhën e udhëzimeve mjaft mirë për të pasur sukses në arsim. Asnjë nga këta persona nuk janë me nevoja të veçanta por ta kanë nevojë për mbështetje shtesë nganjëherë nga ndonjë specialist nëse ata përparojnë mirë në arsim. Nevojat e tyre duhet të përfshihen në secilën politikë dhe strategji për të ndryshuar dhe zhvilluar programet dhe kualifikimet arsimore profesionale për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta.

Nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale kanë probleme të mëdha me të kuptuarit, mbajtjen mend, zgjidhjen e problemeve dhe aftësinë për mësimnxënie në të njëjtin nivel me kolegët e tyre. Personat me aftësi me kufizim të lehtë (IQ 50–69 aftësi kognitive prej gjysmës deri në 2/3 e standardit) mund të mos jenë të dukshme në fëmijërinë e hershme dhe mund të mos identifikohen përderisa nxënësit të fillojnë shkollën. Personat me kufizim të lehtë të aftësive intelektuale mund të jenë të aftë të mësojnë, lexojnë dhe të kenë shkathtësi në matematikë në nivel të përafërt me fëmijët e moshës 8 deri 9 vjeçare, por shpesh nuk mund të mësojnë leximin, shkrimin apo llogaritjen deri në një nivel të arsyeshëm. Ata mund të mësojnë shkathtësi praktike dhe të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të kenë sukses në punësim kur nuk kërkohen shkathtësi të larta. Nevojat e tyre për arsim dhe aftësim profesional duhet të përfshihen në politikë dhe strategji. Në veçanti duhet të zhvillohen kualifikimet profesionale praktike në nivelet 1 dhe 2, përderisa nivelet 3 dhe 4 gjithmonë do të jenë përtej aftësive të tyre. Mësimdhënësit që punojnë me nxënësit me kufizim të lehtë të aftësive intelektuale kanë nevojë për aftësime të përshtatshme në shërbim për tu mundësuar atyre thjeshtësimin e metodave të mësimdhënies dhe duke ju shmangur leximit dhe shkrimit si metoda të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Kufizimi i moderuar i aftësive intelektuale (IQ 35–49) gjithmonë është i pranishëm brenda viteve të para të jetës dhe individët me këtë nivel të aftësive rrallë mund të punojnë në një ambient të hapur pune pa mbështetje të ofruar. Duke marrë parasysh nivelin aktual të papunësisë në Kosovë punësimin me mbështetje nuk i është dhënë prioritet.

Mbështetja dhe mbikëqyrja e personit me aftësi të kufizuara të theksuara apo të thella (IQ me të ulët se 35) gjatë tërë kohës së punësimin nuk do të jetë i mundshëm. Nxënësit me këto nivele të vështirësive kanë nevojë të mësohen në shkolla speciale apo në klasa speciale nga mësimdhënësit të cilët janë të aftësuar dhe kanë shkathtësi në arsim për këto aftësi të kufizuara intelektuale. Duhet të zhvillohet një kurrikulë

alternative me fokus në shkathtësitë e komunikimit, shkathtësitë për jetë të përditshme dhe pavarësi maksimale brenda kufizimeve të këtyre nxënësve, që mbulon fazat e arsimit fillor dhe të mesëm.

Aftësia e kufizuar fizike mund të ketë apo mos të ketë ndikim në mësim. Kushtet që kanë ndikim në pjesën e poshtme të trupit apo këmbët ashtu që individët përdorin shkopin, shkopin ndihmës për ecje dhe karrocën do të ketë ndikim të dukshëm për qasje në ndërtesa, lëvizje brenda ndërtesave, përdorim të transportit publik dhe aftësi qëndrimi për kohë më të gjatë për kryerjen e aktiviteteve të caktuara apo të operojnë në ambiente të caktuara, por nuk ka ndikim në kapacitetin e individit për të mësuar.

Ndërsa, për rastet kur aftësitë e kufizuara kanë të bëjnë me duar, apo koordinim të duarve, individit mund të ketë vështirësi në shkrim, punë me kompjuter, manipulim me pajisje apo mbajtjen dhe shfletimin e fletëve apo librit. Tek individët tjerë mund të kenë ndikim kufizimet sa i përket aftësive të tyre fizike dhe intelektuale. Ata kanë nevojë që ofrimi të bëhet jo vetëm për aftësitë e tyre fizike, të cilat mund të përfshijnë vështirësitë në të dëgjuar dhe të pamur si dhe në të lëvizur. Këta nxënës me aftësi të kufizuara fizike nuk kanë nevojë për aftësim special por nxënësit kanë nevojë të kenë qasje në ndërtesat, pajisjet, ndihmat dhe zbatimet e nevojshme.

Vështirësitë në të dëgjuar rangohen nga të humburit e lehtë të të dëgjuarit deri në shurdhim të plotë. Humbja e të dëgjuarit dhe shurdhimi mund të manifestohen ose pas lindjes, me rastin ndonjë sëmundje apo lëndimi, ose mund të jetë e lindur që do të thotë se humbja e të dëgjuarit apo shurdhimi është prezentë qysh nga lindja e personit. Meqenëse shkathtësitë gjuhësore dhe komunikuese zhvillohen më shpejtësi në fëmijëri. Posaqërisht para moshës 3 vjeçare, fëmija që ka humbje të dukshme të të dëgjuarit që nga lindja, apo mund ta ketë fituar atë humbje shumë herët pas lindjes e kanë të pamundshme zhvillimin e të folurit dhe gjuhën e tyre në mënyrë normale përveç nëse janë në gjendje të mësojnë gjuhën e shenjave nga faza e hershme, atëherë aftësia e tyre për të mësuar do të jetë e dëmtuar.

Intervenimi i hershëm dhe mësimdhënia e duhur dhe përdorimi i gjuhës së shenjave në arsim janë vitale nëse fëmijët mund ta arrijnë potencialin e tyre dhe të përfitojnë nga AAP. Gjuha shqipe duhet të mësohet në mënyrë shumë të strukturuar si gjuhë e dytë në mënyrë që fëmiju të bëhet plotësisht i aftë dhe të jetë në gjendje të përballojë përmbajtjen teorike të arsimit dhe të mund të lexoj dhe shkruaj deri në nivelin që kërkohet si parakusht për qasje në nivelet 3 dhe 4 të AAP.

Mësimdhënësit e nxënësve të shurdhër duhet të jenë të rrjedhshëm në gjuhën e shenjave dhe ta zotojnë mësimdhënien. Atëherë kur fëmijët janë të rrjedhshëm në gjuhën e shenjave dhe shqipe mund të përfshihen në arsimin e rregullt nëse kanë interpretuesin e shenjave që të interpretoj për ta dhe nëse mësimdhënësit e tyre përdorin metoda të përshtatshme të mësimdhënies. Nxënësit me pajisje për lehtësim të të dëgjuarit po ashtu mund të përfitojnë nga metodat vizuale të mësimin, materialet mësimore dhe shpjegimet e duhura të terminologjisë dhe teknikës së re.

Vështirësitë në të pamur rangohen nga humbja e lehtë e të pamurit përmes të pamurit të dobët deri në verbim të plotë, ku individët nuk mund të bëjnë dallimin midis dritës dhe errësirës.

“Të pamurit e dobësuar” është një term i cili përdoret për të përshkruar problemin e të pamurit i cili nuk mund të korrigjohet me natë të syzave, kontakt lensave apo trajtimin mjekësor dhe mund të shkaktojnë disa vështirësi tek personat gjatë aktiviteteve të tyre të përditshme. Nxënësit të cilëve mund tu përmirësohet të pamurit përmes syzave, kontakt lensave apo trajtimin mjekësor duhet të trajtohen në faza sa më të hershme, në mënyrë ideale para se të fillojnë shkollimin. Nxënësit me të pamur të dobësuar, të cilëve u nevojitet mbështetje e lehtë në të pamur siç janë zmadhuesit e dorës apo të fiksuar apo përdorimi i shkronjave me font me të madh, atëherë këto kjo mbështetje duhet tu ofrohet gjatë tërë kohës së arsimit të tyre. Ata pastaj mund të përballojnë mësimin në klasa të zakonshme por mësimdhënësit e tyre duhet të jenë të dinë se si ti ndihmojnë sa më mirë që ata të mësojnë.

Të rinjtë e verbër duhet ta mësojnë Braille dhe të kenë pajisje për lexim dhe shkrim në Braille qysh nga fillimi i shkollimit të tyre, shumë para se të arrijnë në fazën për AAP. Në mënyrë të barabartë ata do të duhej të kenë mësuar për të lëvizur dhe marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të sigurt gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre të përditshme. Megjithatë mësimdhënësit e arsimit përgjithshëm duhet të kenë shkathtësi specifike dhe të kuptuar se si mund të mësojnë më së miri nxënësit e verbër dhe se si të përfitojnë arrijtjen e kualifikimit profesional në AAP. Autizmi është aftësi e kufizuar gjatë tërë jetës e cila ndikon në mënyrën e perceptimit të botës nga personi, përpunimin e informative apo raportet me njerëz të tjerë.

Autizmi shpesh përshkruhet si 'çrregullim i spektrit' sepse gjendja e tyre ka ndikim tek njerëzit në mënyra dhe shkallë shumë të ndryshme. Për AAP është relevant vetëm niveli me i lartë i spektrit, i cili shpesh është i njohur si sindroma Asperger.

Personat me këtë gjendje kanë inteligjencë normale por vështirësi në tri fushat kryesore siç janë: komunikimi, ndërveprimi shoqëror dhe imagjinata. Ata kanë probleme në raport me të tjerët, nuk i kuptojnë raportet shoqërore dhe kanë vështirësi në të kuptuarit e ndjenjave dhe emocioneve të të tjerëve. Ata shpesh duken të çuditshëm, të ndrojtur dhe atakues. Ata shpesh kanë interesim të veçantë për gjëra të cilat ju bëhen obsesion. Ata janë të suksesshëm në punën e tyre në fushat që ngjallin interes të veçantë për ta dhe që nuk kërkojnë ndërveprim me të tjerët.

Pasi të jenë në gjendje të përballojnë aspektet shoqërore të punësimit apo të gjejnë punë të cilat nuk kërkojnë shumë ndërveprim me të tjerët, ata shpesh here janë në gjendje të punojnë mire në punët e tyre të cilat kërkojnë qëndrueshmëri, vëmendje të hollësishme, njohuri faktike siç janë llogaritjet apo punët në lidhje me mekanikën, shkencën apo kompjuterikën. Mësimdhënësit e AAP të cilët punojnë me nxënësit me sindrom Asperger do të kenë nevojë për informata dhe udhëzime se si të arrihet sukcesi me i mire i nxënësve.

Termi vështirësi emocionale dhe në sjellje është një emërim i gjerë i cili është përdorur për të formuar rangun e vështirësive më specifike siç janë sjellja e cila pengon mësimin e vet nxënësit apo mësimin e kolegeve

të tyre, shenjat e turbulencës emocionale siç është të qarit e pazakonshme, tërheqja nga situatë shoqërore dhe vështirësi në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve me të tjerët. Nxënësit të cilët do të hyjnë në AAP do të jenë ata të cilët vështirësitë në sjellje dhe emocionale nuk janë aq ekstreme në mënyrë që ata mund të mësojnë në klasa të përgjithshme, por shpesh kërkojnë mbështetje specifike nga ana e mësimdhënësve. Llojet e sjelljeve të cilat mund të krijojnë barrierë në të mësuarit e nxënësit apo mësimin e të tjerëve përfshijnë sjellje siç janë mos angazhimi i tyre në detyrat e caktuara nga mësimdhënësi, lozja me laps apo endja e panevojshme nëpër klasë.

Sjellja çrregulluese mund të përfshijë daljen nga klasa, përzierje në gjësendet e të tjerëve, apo biseda me të tjerët dhe pengimin e procesit mësimor. Sjellja agresive mund të përfshijë fjalosjen, përlëshjen apo sharjen. Vështirësitë shoqërore përfshijnë përpjekjet jo të duhura dhe refuzim për angazhim me të tjerët dhe mësimdhënësin. Këto lloje të sjelljeve shpesh here janë situatat më të vështira me të cilat duhet të përballen mësimdhënësit. Disa strategji janë cekur në Pakon e veglave, por mësimdhënësve u nevojitet trajnim specifik në shërbim që të trajtojnë këto çështje në klasë dhe emocionet e tyre gjatë punës me të rinjtë që kanë këto vështirësi.

Aftësitë e kufizuara dhe vështirësitë e padallueshme janë ato të cilat nuk dallohen menjëherë nga të tjerët. Këto përfshijnë shëndetin fizik dhe mendor, siç janë: zemra, epilepsia, diabeti, çrregullimet në ushqim, depresioni ose çrregullimi dhe stresi post-traumatik. Nxënësit me gjendje të tillë mund të ndikohen nga ilaçet që ndihmojnë me vështirësitë e tyre si dhe nga vet gjendja. Është e dobishme që mësimdhënësit të jenë të vetëdijshëm për ndikimin nga gjendja apo ilaçet e nxënësve individual dhe të kuptoj se çka kanë nevojë të bëjnë ata për të mundësuar suksesin e nxënësve. Po ashtu është e rëndësishme që nxënësit të këshillohen që të marrin parasysh vështirësitë e tyre kur bëjnë përzgjedhjen e programit të AAP dhe profesionit potencial pasi që disa të rinj ngurrojnë të shprehin kufizimet e tyre dhe mund të jenë tepër optimist në lidhje me atë se çfarë janë në gjendje të bëjnë.

PJESA 2: ZHVILLIMI I POLITIKËS DHE IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË PËR AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMET PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA APO VËSHTIRËSI NË MËSIM

ZHVILLIMI I POLITIKËS DHE STRATEGJISË

Zhvillimi i strategjisë për arsim profesional për të rinjtë me aftësi të kufizuara për mësimnxënie duhet të filloj me një politikë. Kjo politikë shpreh zotimet e Qeverisë përmes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe ministritë tjera relevante, agjencionet dhe organizatat për ofrim të përshtatshëm të arsimit profesional për të rinjtë dhe aftësi të kufizuara apo vështirësi në mësimnxënie që do tu ndihmoni atyre të gjejnë dhe mbajnë punët në fuqinë punëtore të shekullit 21.

Politika duhet të marrë parasysh të gjitha aftësitë e kufizuara dhe nevojat tjera të veçanta të theksuar në pjesën e 1-rë të këtij dokumenti, dhe çështjet në lidhje me ato.

Një politikë e sugjeruar për diskutim dhe zhvillim është cekur në shtojcën 1. Pranimi i politikës së tillë do të ofroj një bazë të shëndoshë të zhvillimit dhe implementimit të arsimit profesional të përmirësuar për të rinjtë me aftësi të kufizuara apo vështirësi në mësimnxënie. Politika e sugjeruar po ashtu mund të shihet si një grup rekomandimesh për punë. Vetë politika apo rekomandimet nuk ndryshojnë asgjë, asgjë nuk do të ndryshoj nëse implementohen ato dhe implementimi i tyre monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë rutinore. Kështu që duhet të vendoset dhe implementohet një strategji e miratuar.

Procesi i planifikimit strategjik përbëhet si në vijim: Vlerësimi i pozitave ekzistuese; Identifikimi i zhvillimeve të dëshiruara të cilat janë përcaktuar në politikë

Vlerësimi i zbrazëtive midis të dyjave dhe çështjet të cilat duhen zgjidhur në mënyrë që të plotësohet zbrazëtia

Formulimi i strategjive dhe hapave veprues që të arrihet nga pozita ekzistuese në pozitën e dëshiruar

Zhvillimi i qëllimeve është hapi kyç në planifikimin strategjik efektiv. Qëllimet janë synime të shkruara të cilat shprehin se çka duhet arritur brenda periudhës kohore specifike. Por qëllimet duhet të ndërtohen mbi baza të sigurta në mënyrë që objektivat e strategjisë të arrihen dhe ndihmojnë sistemin e AAP të arrij synimet e tij për tu bërë gjithëpërfshirës. Qëllimet efektive kanë katër karakteristika të përbashkëta të cilat kur të përmbushen do të rrisin gjasat e arritshmërisë dhe planifikimin më preciz.

Këto karakteristika janë:

1. Qëllimi duhet të jetë specifik. Sa më specifik të jetë qëllimi aq më shumë rriten gjasat për ta arritur atë. Secila organizatë apo agjencion duhet të jetë e qartë në lidhje me faktin se cilin qëllim po e arrin apo mbështes.

2. Qëllimi duhet të jetë i matshëm. Duhet të ekzistoj një mënyrë për të përcaktuar se a është duke bërë progres në arritje të qëllimit arsimit në përgjithësi apo sistemi i AAP është në veçanti.

Duhet të ekzistoj një mënyrë e identifikimit të qartë se kur arrihet qëllimi.

3. Qëllimi duhet synuar. A do të na shpie qëllimi tek rezultatet e dëshiruara? A kontribuon qëllimi në arritjet e një apo qëllimeve kryesore të paraqitura në politikë?

4. Qëllimi duhet jetë specifik në afat kohor. Afati i fundit për arritjen e qëllimit është kritik. Arritja e qëllimeve është zakonisht e bazuar në një periudhë specifike kohore, dhe përgjegjësia për arritjen e qëllimit rritet dukshëm nëse është e lidhur me një afat kohor.

IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË

Asnjë iniciativë e cila është jashtë qëllimeve strategjike nuk duhet marrë parasysh dhe të gjitha iniciativat duhet të kenë rol të qartë në dorëzimin e strategjisë dhe përbushjen e kërkesave të politikës. Zhvillimi i qëllimeve efektive të cilat janë në lidhje me politikën duhet të jenë të matshme, specifike, e synuar dhe e ndjeshme në kohë do të mundësojnë implementimin e planit strategjik, por progresi duhet të monitorohet për tu siguruar se secili hap është kryer në kohën e caktuar nga ana e atyre që janë përgjegjës për të bërë këtë.

Strategjia ka nevojë të implementohet nga një rang agjencionesh qeveritare dhe jo qeveritare në pajtueshmëri me kompetencat dhe përgjegjësitë në mënyrë që të bëhet vitale dhe të gjitha palët e interesit e kanë të qartë procesin dhe janë të zotuar për tu siguruar se qëllimet për të cilat ata janë përgjegjës janë arritur brenda fatit të caktuar kohor.

ÇKA DUHET MËSUAR

Përmbajtja e secilit modul të AAP mbetet e njëjtë për secilin nxënës. Kur të zhvillohet në tërësi qasja modulare me mundësi brenda nivelit të njëjtë të secilit profil, nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja të

veçanta do të jenë në gjendje të zgjedhin modulet të cilat i ngritin shkathtësitë e tyre dhe zvogëlojnë apo eliminojnë vështirësitë e tyre.

SI DO TË MËSOHET

Hollësitë se si do të ndryshohet mësimdhënia, mësimnxënia dhe regjistrimi për nxënës me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta janë të paraqitura në këtë Pakon e veglave. Në përgjithësi mësimdhënësit

duhet të fokusohen në faktin se nxënësit me aftësi të kufizuara janë individ. Krahasimet me nxënësit tjerë që kanë nevojë për ndryshime të ngjashme apo që duket të kenë vështirësi të njëjta duhet të mënjanohen.

Supozimet e bazuara në përvojën paraprake apo të tanishme mund të jenë të gabuara apo të dëmshme. Për shembull, dy nxënës qe përdorin karrocë ndihmëse nuk kanë nevojë për ndryshime të njëjta. Klasa duhet të jetë e pajisur për qasje me karrocë ndihmëse por ngjashmëritë duhet të ndalen këtu. Kur nxënësi ulet në klasë, në karrocë ndihmëse apo transferohet në banka të rregullta qe të mund të menaxhoj nxënësi kërkesat për lexim dhe shkrim të një klase dhe si ndërvepron nxënësi brenda klasës ndryshon nga personi në person.

Nxënësit me aftësi të kufizuara përfshirë një aftësi të kufizuar apo vështirësi në të pamur mund të kenë nevojë për kohë shtesë për të kryer aktivitetet në lidhje me kursin pasi qe ata kanë nevojë për pushime me të shpeshta. Disa nxënës do të zgjedhin zhvillimin e dialogut në lidhje me aftësitë e tyre të kufizuara dhe ndryshimet, ndërsa të tjerët jo. Nëse nxënësi zgjedh diskutimin e hapur në lidhje me aftësitë e tij apo të saj të kufizuara, përmbajtja dhe diskutimi do të mbahet si private dhe në konfidencë. Nuk është e pa zakonshme qe njerëzit të ndjehen në siklet kur diskutojnë aftësitë e tyre të kufizuara. Një mendje e hapur duke mënjanuar

stereotipet e imixheve dhe përvojave dhe pranimin e nxënësit për aftësitë e tij apo të saj janë të rëndësishme në krijimin e raporteve të suksesshme të punës për secilin nxënës.

Syllabusi i kursit i shkruar qartë dhe i dhënë paraprakisht dhe i cili i vihet në dispozicion secilit nxënës do të jetë i dobishëm për diskutimet paraprake në lidhje me faktin se çfarë ndryshimesh janë të nevojshme dhe kur janë të nevojshme të bëhen ato. Pastaj mund të planifikohet paraprakisht ofrimi. Standardet për përmbajtjen e kursit dhe vlerësimin dhe testimin e shkathtësive, njohurive dhe kuptueshmërisë nuk duhen ndryshuar për nxënësit me aftësi të kufizuara. Nëse janë të nevojshme modifikimet ato duhet të bëhen në mënyrat me të cilat është mësuar nxënësi, se ai apo ajo mban shënime, kryen detyra apo merr pjesë në aktivitete praktike. Nëse aktivitetet specifike të kursit janë të pamundshme për nxënësin duhet marrë parasysh alternativat me detyra të njëjta. Nxënësi individual duhet të lutet të marrë pjesë në diskutim të detyrave alternative për të përcaktuar se sa mund ti realizoj ato, prandaj standardet e nevojshme apo niveli i vlerësimit të kursit nuk duhet të reduktohen.

... KUSH DO TË ZHVILLOJ MËSIMDHËNJËN ...

Nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta do të mësohen nga mësimdhënësit e njëjtë sikur shokët tjerë të klasës. Trajnimi në shërbim duhet të zhvillohet rregullisht për tu mundësuar mësimdhënësve të AAP për të fituar shkathtësitë e nevojshme për tu përballur me rangun e pritur të aftësive të kufizuara dhe vështirësitë të cilat do ti kenë nxënësit në klasat e tyre.

Për shembull, mësimdhënësit për floktar nuk do të kenë nxënës të verbër apo nxënës me paralizë cerebrale por mund të kenë nxënës të shurdhër apo nxënës me aftësi të kufizuara të fshehura.

Mësimdhënësit e AAP nuk pritet të bëhen specialist në lidhje me aftësitë e kufizuara dhe nevojat e veçanta dhe duhet bërë përgatitjet për tu siguruar se në rast nevojë do të jetë në dispozicion të tyre ndonjë informatë e specializuar, resurse dhe pajisje për mësimdhënie. Ata po ashtu duhet të jenë të vetëdijshëm në lidhje me praktikën themelore të mirë në mësimin e nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta posa të dihet se do ketë një nxënës të tillë në klasën e tyre.

SI DO TË VLERËSOHET SUKSESI DHE KUALIFIKIMET E DHËNA

Pakon e veglave përmban informatat dhe udhëzimet në krijimin ndryshimeve për tu mundësuar të rinjve me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta për të demonstruar shkathtësitë, njohuritë dhe kompetencat e tyre efektive. Standardet që pritet të arrijnë ata janë të njëjta me ato të kolegëve të tyre dhe nuk ka nevojë të bëhen ndryshime në lidhje me atë që çka pritet të dinë, kuptojnë apo bëjnë ata.

Derisa të modularizohen tërësisht programet e AAP dhe opsionet janë në dispozicion, kjo do të thotë se disa nxënës mund të arrijnë kualifikime të pjesshme. Kjo mund të njihet në certifikatën e tyre ku paraqiten tregues në lidhje me kualifikimin se në cilat fusha ka arritur të përmbush standardet e kërkuara nxënësi dhe cilat element nuk kanë qenë në gjendje të arrihen.

RESURSET

Ofruesit e AAP kanë nevojë për qasje në resurse për tu mundësuar atyre për të zhvilluar arsimin dhe aftësimin profesional për personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta.

Kjo përshin qasjen në:

- Këshilla nga specialistët dhe mbështetje nga ekspertët në fusha të veçanta në rast nevoje, përfshirë vlerësimin e nxënësve dhe shkathtësitë dhe nevojat e tyre të veçanta;
- Shërbime të specializuara në rast nevoje siç janë Brailing dhe transkriptat e materialit të kursit, ndihma për shkurt pamësi, interpretim shenjash për të shurdhër apo pajisje ndihmëse për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike;
- Trajnime në shërbim në lidhje me vetëdijesimin e aftësive të kufizuara për mësimdhënie dhe mësimnxënie, shkathtësi bazë për mësimdhënien e nxënësve me aftësi të kufizuara specifike, siç janë mos të folurit me nxënësit me humbje të dëgjuarit kur nuk i shohin përballë apo ofrimit të materialeve mësimore kështu që nxënësit të mos kenë vështirësi.

SHTOJCA 1

Kjo politikë e sugjeruar e AAP për nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta paraqet një synim të përgjithshëm të politikës dhe pesë synime specifike. Është përfshirë këtu si bazë për diskutim në lidhje me mënyrën se si të shkohet përpara me zhvillimin e

modifikimeve për sistemin e AAP në Kosovë. Po ashtu mund të përdoret si një grup rekomandimesh për zhvillimin në vazhdimësi të nxënësve të AAP me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta në Kosovë. Po ashtu është e radhitur edhe në Pakon e veglave.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM

Kosova do të arrij një sistem të shkëlqyeshëm gjithëpërfshirës të sistemit të AAP me programet në dispozicion nga niveli 1 deri në nivelin 4 i cili ju mundëson nxënësve me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta qasje në AAP relevante të kualitetit të lartë, i cili ju mundëson atyre që të mësojnë në mënyrë efikase dhe të punësohen pa marrë parasysh gjininë, rrethanat jetësore, shëndetit, aftësisë së kufizuar, shkallës së zhvillimit, kapacitetit për të mësuar apo rrethanat financiare.

Të gjitha organizatat relevante qeveritare dhe jo qeveritare dhe private do të punojnë në harmoni për të zhvilluar dhe ruajtur një sistem gjithëpërfshirës të AAP në Kosovë.

Synimi 1 i politikës

Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta do të pajisen me shkollim fillor dhe shkollim të mesëm të ulët i cili do të përmbush nevojat e tyre specifike të mësimin kështu që ata të mund të përparojnë në mënyrë të suksesshme në programet akademike apo në programet e AAP.

Mësimdhënësit e specializuar do të kenë shkathtësitë, njohuritë dhe të kuptuarit për tu mundësuar atyre të zhvillojnë arsim të specializuar për ata të cilët kanë nevojë për atë arsim.

Synimi 2 i politikës

Të gjithë të rinjtë me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta do të kenë qasje në AAP përfshirë kualifikimet e standardeve të njëjta sikur kolegët e tyre për përgatitjen e tyre për punë në fushën e tyre të preferuar profesionale. Kjo do të mbështetet përmes ndryshimit të qëndrimit, modifikimin e përshtatshëm të metodave dhe resurseve të mësimdhënies, përdorimi efikas i ndihmave dhe zbatimeve përfshirë përdorimin e informatave dhe teknologjisë komunikuese dhe përmes ofrimit të ndryshimeve të nevojshme ndaj ambientit. Vlerësimet duhen modifikuar për tu përshtatur nevojave të kandidatëve me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta pa pasur nevojë të ndryshohen standardeve. Këta individë me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta të cilët nuk kanë në gjendje të qasen kurrikulit të rregullt të plotë apo kualifikimit të plotë në fushat e preferuara profesionale, do të jenë në gjendje të fitojnë kualifikim të pjesshëm përmes sistemit modular të AAP për tu mundësuar atyre të arrijnë brenda kufijve të aftësive të tyre të kufizuara.

Qëllimi 3 i politikës

Kosova do të zhvilloj një shërbim koherent gjithëpërfshirës të AAP i cili përmbush nevojat e me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta, kërkesat kombëtare dhe në përputhje me praktikën me të mirë ndërkombëtare.

Qëllimi 4 i politikës

Mësimdhënësit e AAP do të kenë shkathtësi, njohuri dhe të kuptuar dhe resurset dhe shërbimet mbështetëse për tu mundësuar atyre të bëjnë modifikime efektive për mësimdhënie dhe mësimnxënie për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të ndryshme dhe me aftësi të ndryshme të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta kështu që ata të mund të mësojnë në mënyrë efektive. Mësimdhënësit dhe vlerësuesit do të kenë shkathtësi, njohuri dhe të kuptuar dhe resurset dhe shërbimet mbështetëse për tu mundësuar atyre të bëjnë modifikime efektive për vlerësime pa pasur nevojë të ndryshohen standardet.

Qëllimi 5 i politikës

Ofruesit profesional do të ofrojnë institucione mbështetëse dhe humane të cilat do të mbështesin të gjithë nxënësit e tyre dhe do të vlerësojnë arritjet e tyre kështu që nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta do të vijojnë mësimin në mënyrë të rregullt, të punojnë me zell në studimet e tyre dhe arrijnë kualifikimet të cilat do tu mundësojnë atyre hyrjen në tregun e punës.

Këto qëllime do të arrihen përmes dhjetë formulimeve të zotimeve:

Formulimi i Zotimit 1

Do të ndërmerren veprime për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien në arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta në mënyrë që ta të përparojnë në mënyrë të suksesshme në arsimin dhe aftësimin e lartë të mesëm dhe profesional. Shkollat speciale do tu japin nxënësve të tyre përgatitjen me të mirë për jetën e tyre në të ardhmen dhe po ashtu të shërbejnë si resurse në sistemin e përgjithshëm të arsimit.

Formulimi i Zotimit 2

Do të ndërmerren veprime për të rritur numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta të cilët nuk kanë vijuar asnjëherë mësimin apo kanë braktisur shkollën para përfundimit të shkollimit fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.

Formulimi i Zotimit 3

Do të ndërmerren veprime për të rritur numrin e të rinjve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta të cilët regjistrohen dhe përfundojnë në mënyrë të suksesshme arsimin dhe aftësimin profesional.

Formulimi i Zotimit 4

Do të ndërmerren veprime për tu siguruar se mësimdhënësit janë efikas në aftësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, për ti mësuar programet e AAP dhe të arrijnë shkathtësi dhe kualifikime relevante ;

Formulimi i Zotimit 5

Do të ndërmerren veprime për tu siguruar se ndryshimet korrekte janë bërë në vlerësime për kandidatët me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta për të pasur sukses në demonstrimin e shkathtësive, njohurive dhe kompetencave të tyre.

Formulimi i Zotimit 6

Do të ndërmerren veprime për monitorimin e arritjeve të kualifikimeve nga personat me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta dhe siguron se çfarëdo modifikimi i kryer për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe ndryshime në vlerësim standardet që ata arrijnë janë të njëjta me ato të kolegëve të tyre.

Formulimi i Zotimit 7

Do të ndërmerren veprime për të përmirësuar qasjen e ofruesve të AAP në një rang me të gjerë të kualitetit të mirë të ndihmave të mësimdhënies dhe resurseve të mësimnxënies të përshtatshme me numrin dhe nevojat specifike të nxënësve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta.

Formulimi i Zotimit 8

Do të ndërmerren veprime për të zhvilluar shërbime mbështetëse të specializuara të cilat do të ofrojnë informata, shkathtësi dhe rekomandime për ofruesit e AAP dhe mësimdhënësit e AAP me zëvendësuesit e nevojshëm si jo specialist për mësimin dhe vlerësimin e aftësive të kufizuara dhe nevojave të veçanta në mënyrë efektive.

Formulimi i Zotimit 9

Do të ndërmerren veprime për tu siguruar se ofruesit e APP të krijojnë institucione mbështetëse dhe humane të cilat mbështesin të gjithë nxënësit e tyre.

Formulimi i Zotimit 10

Mekanizimi duhet të vendoset për të harmonizuar planifikimin relevant, krijimin e politikave, zhvillimin dhe dhënien e shërbimeve në mënyrë që sistemi arsimor Kosovar mund të ofroj një shërbim gjithëpërfshirës i cili përmbush kërkesat kombëtare dhe është në pajtim me praktikën me të mirë ndërkombëtare.

Secili formulim i zotimit është i përkrahur nga aktivitetet të cilat përcaktojnë se çka do të bëhet për të përmbushur formulimin e zotimit, i cili shpie në arritjen e qëllimeve. Lista e aktiviteteve ka për qëllim të ilustruj me shembuj veprimet që mund të ndërmerren dhe nuk është urdhëruese apo lodhëse.

SEKSIONI 1: **HYRJE**

1.1 Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), me mbështetje të projekteve të financuara nga donatorët dhe OJQ, është duke punuar në arritjen e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës universal i cili përfshin arsimin dhe aftësimin profesional (AAP).

1.2 Arsimi i mesëm i lartë i cili përfshin AAP po bëhet i detyrueshëm dhe regjistrimi në shkolla mbajtja në çdo fazë të arsimit është duke u ngritur. Ofruesit duhet të gjejnë mënyra për përfshirjen e nxënësve të cilët ata nuk i kanë llogaritur paraprakisht apo për të cilët ata nuk kanë bërë ofrim efektiv. Për ofruesit e AAP kjo përfshin nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. Kjo politikë është e nevojshme si bazë për përmirësimin e AAP për këta nxënës. Nevoja për zhvillimet e cekura këtu është e bazuar në zotimet e qeverisë për të drejtat njerëzore dhe arsimore dhe në nevojat e vendit për të ngritur potencialin e plotë të popullsisë së saj që ta zënë vendin e tyre në botën moderne. Kosova me numrin të ulët të popullsisë ka nevojë për arsimin dhe shkathtësimin e të gjithë banorëve që sistemi i arsimit mund të ofroj. Kjo politikë është dizajnuar për të mbështetur Qeverinë në arritjen e synimeve të saj

duke ofruar qasje në AAP të cilësisë së lartë për të gjithë nxënësit, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta.

1.3 Duke u koncentruar në përfshirjen e suksesshme të atyre të cilët ende nuk kanë qasje në AAP apo nuk përfitojnë nga AAP, kjo politikë përcakton një plan për tu siguruar që të gjithë Kosovarët të kenë qasje në sistemin e AAP. Kjo përcakton mbështetjen e nevojshme që duhet ofruar për ata të cilët kanë nevojë tu mundësohet mësimi në mënyrë efikase. I tërë sektori i AAP është bërë më efektiv përmes të përfshirjes së metodave të mësimdhënies dhe qasjes më fleksibile ndaj mësimi.

1.4 APP gjithëpërfshirës ka nevojë për zhvillimin e një sistemi fleksibil i cili përfshin një rang ambientesh të ndryshme mësimore dhe lloje të ndryshme të mbështetjes në mënyrë që të gjithë individët mund të mësojnë në mënyrë efikase në pajtim me kapacitetet, shkathtësitë, talentet dhe interesave të tyre intelektuale. Nga AAP përfitojnë të gjithë nxënësit por është dizajnuar për tu ofruar përfitim të veçantë nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta duke gjetur mënyrat e minimizimit të mangësive të cilat i pengojnë në arritjen e potencialit të tyre.

1.5 Arsimi gjithëpërfshirës në secilin nivel përfshirë AAP ka një fokus të qartë për nevojat e grupeve jo të favorizuara dhe të cenueshme por edhe në përfitim për të gjithë nxënësit. Kjo ndodh për shkak se sistemi gjithëpërfshirës i AAP me mënyrat se si ofrohet të mësimi dhe mënyrat se si mësimdhënësit e promovojnë mësimin janë më fleksibil dhe i kushtojnë kujdes të veçantë se si mund të mësoj më së miri secili individ.

1.6 Fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit janë përcaktuar si persona me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta nëse ata kanë nevojë për diçka që është përtej asaj çka ofrohet në përgjithësi si standard në sistemin e arsimit.

1.7 Një sistem i arsimit gjithëpërfshirës i cili përfshin AAP është definuar si sistem i cili përfshin dhe përmbush nevojat e të gjithëve, përfshirë atyre me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta pa marrë parasysh gjininë, rrethanat jetësore, shëndetit, aftësisë së kufizuar, shkallës së zhvillimit, kapacitetit për të mësuar, nivelit të arritshmërisë, kushteve financiare apo rrethanave tjera. Asnjë person nuk përjashtohet nga arsimi dhe sistemi i arsimit ofron modifikime dhe ndryshime të cilat i përmbushin nevojat e ndryshme të të gjithë nxënësve. MASHT udhëheq zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës të AAP por zhvillimi i duhur i një sistemi të tillë varet nga nivelet e larta të koordinimit dhe bashkëpunimit me Ministritë tjera, OJQ dhe ofruesit privat të cilët do të jenë përgjegjës për shërbimet e tyre të cilat formojnë një pjesë të sistemit të AAP.

1.8 Pasi që Kosova është zotuar për një sistem arsimor gjithëpërfshirës, AAP duhet të bëhet gjithëpërfshirëse. Një sistem arsimor gjithëpërfshirës u mundëson fëmijëve, të rinjeve dhe të rriturve që të mësojnë në mënyrë efikase sepse nevojat e tyre përmbushen kudo

që të jetë e mundshme si në arsimin parashkollor, shkollor, programe të AAP, kolegje dhe universitete me mësimdhënie dhe mbështetje të duhur.

Kurrikulat dhe metodat e mësimdhënies të përdorura në çdo klasë, në çdo shërbim kanë parasysh aftësitë e ndryshme të nxënësve, duke pranuar se nxënësit me apo pa nevoja të veçanta arsimore të cilët janë në të njëjtën klasë apo grup kanë nivele të ndryshme të aftësive dhe është e nevojshme mbështetja e ndryshme.

Planet individuale arsimore dhe mbështetja shtesë përdoren për ata që kanë nevojë. Plani shpreh se si mund të ndihmohet nxënësi që të mësoj në mënyrë më efektive. Mbështetje shtesë është dizajnuar për të ndihmuar nxënësit që të arrijnë potencialin e tyre, pa marrë parasysh se a kanë apo jo ata plane individuale mësimore.

1.9 Personave të cilëve nuk mund të përmbushin nevojat e tyre në ambientin e përgjithshëm sistemi arsimor përfshin ofrimin e specializuar në mënyrë që të mund të mësojnë në mënyrë efektive. Kur ekziston mundësia nxënësve në ofrimin e specializuar ju mundësohet mësimi i tillë që të mund të lëvizin në ofrimin arsimor të përgjithshëm në bazë të pjesshme apo të plotë.

Për të rinjtë me aftësi të kufizuara të plota apo komplekse posaçërisht atyre me aftësi të kufizuara intelektuale, programet e AAP do të ofrohen në shkollat të specializuara por këto programe do të jenë pjesë e sistemit të përgjithshëm të AAP, me rregulla, standarde dhe kërkesa të sigurimit të cilësisë si ato të gjitha programeve tjera të AAP.

Niveli i programeve hyrëse 1 dhe 2 do të zhvillohen për të përmbushur nevojat e atyre nxënësve dhe të tjerëve që kanë nevojë për programe të AAP në këtë nivel.

SEKSIONI 2: **FORMULIMI I PROBLEMIT**

2.1 Kosova ende nuk ka sistem të AAP i cili përmbush nevojat e të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta. Kjo jo vetëm që është në kundërshtim me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta por do të thotë se vendi po humb potencialin e disa banorëve ekzistues dhe atyre të së ardhmes. Shumë fëmijë të moshave të ndryshme nëpër shkollë nuk po marrin arsimin e duhur apo nuk janë duke përfituar nga arsimit sepse sistemi aktual nuk po ju mundëson atyre regjistrimin apo nuk po i përmbush nevojat e tyre pas regjistrimit të tyre. Ata ose braktisin mësimin apo nuk përfitojnë në mënyrë të plotë nga vijimi i mësimave në shkollë dhe prandaj ata nuk mund të qasen me sukses AAP sepse atyre ju mungon arsimi bazë dhe shkathtësitë specifike në lidhje me aftësitë e tyre të kufizuara.

2.2 Nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta të cilëve ju mundësohet regjistrimi në programet e AAP dhe vijojnë mësimin në programet e AAP ata nuk janë duke mësuar, apo nuk janë duke mësuar aq sa mundën në modifikimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mësimdhënien e përmirësuar dhe më shumë mbështetje.

Gjatë punësorive regjionale për vet vlerësim të zhvilluara nga KOSVET 5 shumë drejtor të shkollave të AAP theksuan se kanë nxënës me aftësi të kufizuara në shkollat e tyre por ata nuk mund të ofrojnë ndonjë mbështetje atyre. Mendimi i përgjithshëm i shprehur në këto diskutime ishte se ata nuk mund të ofrojnë arsim të duhur këtyre nxënësve sepse nuk ekziston infrastruktura dhe stafi i trajnuar për të punuar me ata nxënës.

SEKSIONI 3: **RACIONALJA**

3.1 Racionalja për këtë politikë është se Kosova ka nevojë për këtë politikë për të arritur përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta në AAP për të ngritur potencialin e njerëzve të tyre për zhvillimin e ardhmërisë së vendit dhe për të përmbushur plotësisht kërkesat ndërkombëtare për të drejtët njerëzore, aftësitë e kufizuara dhe të drejtat arsimore për të cilat është zotuar Qeveria.

3.2 Kosova ka një numër të ultë të popullsisë dhe për këtë arsye qeveria duhet të siguroj që secili banor të jetë në gjendje të jap kontribut të madh të mundshëm për zhvillimin e vendit në të ardhmë në arenën ndërkombëtare. Zhvillimi i një sistemi gjithëpërfshirës i AAP është i rëndësishëm për arritjen e misionit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të zhvilluar një shërbim të AAP të cilësisë së lartë dhe efektiv i cili ju përgjigjet nevojave të vendit dhe botës moderne.

SEKSIONI 4: PRINCIPET E POLITIKËS

4.1 Të gjithë individët kanë potencial për të mësuar dhe do të ofrohen shërbime arsimore të cilat do tu ndihmojnë atyre të mësojnë në mënyrë sa më efektive;

4.2 Secili fëmija dhe i ri me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta kanë të drejtë në shkollim fillor dhe shkollim të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe programe të AAP të cilat ju mundësojnë atyre për të arritur potencialin e tyre dhe përgatiten për jetë të suksesshme si të rritur.

4.3 Shumica e nxënësve me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta kanë nevojë të vijojnë programet e rregullta të AAP ku modifikimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe ndryshimet brenda vlerësimit për tu mundësojnë atyre të kenë sukses në nivel të njëjtë me kolegët e tyre.

Përmbajtja dhe standardet e kurseve nuk do të ndryshohen por do të hiqen sa më shumë që ka mundësi barrierat për përfundim të suksesshëm të AAP nga nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta.

4.4 Nxënësit të cilët kanë nevojë për më shumë adaptime në mësimnxënie se sa mund të ofrohet në mënyrë të suksesshme në ambientin e rregullt do të vijojnë AAP në shkolla po kurse speciale. Arsimi i tyre paraprak i AAP do të fokusohet në zhvillimin e shkathtësive për jetën e tyre si të rritur të cilat do tu japin atyre bazat për një program të AAP.

Kualifikimet do të zhvillohen në nivele të cilat do të jenë të përshtatshme për këta nxënës.

SEKSIONI 5: ÇËSHTJET KYÇE DHE SYNIMET SPECIFIKE TË POLITIKËS PËR PËRFSHIRJE TË SUKSESSHME TË NXËNËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE ME NEVOJA TJERA TË VEÇANTA NË PROGRAMET E AAP

Ky seksion i politikës paraqet çështjet kyçe të qëllimeve specifike të politikës për përfshirje të suksesshme të nxënësve me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta në programet e AAP. Prandaj edhe nëse arrihen të gjitha këto synime grupet në vijim ka gjasa të mos përfshihen në AAP, pa marrë parasysh sa të suksesshme bëhen programet e AAP për përmbushjen e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta .

- Fëmijët me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta që kanë braktisur shkollimin para përfundimit të shkollimit bazë;

- Fëmijët me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta që janë regjistruar në shkollë por nuk kanë përfituar nga ajo çka ofrohet momentalisht;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta që janë të rrezikuar nga dështimi i përfundimit të arsimit bazë apo nga dështimi i ngritjes së potencialit të tyre për shkak të një sistemi jo fleksibil, një kurrikuli të pa përshtatshëm apo metoda jo efektive të mësimdhënies të cilat i pengojnë ata në mësim.

Pa adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me arsimin para AAP të gjitha modifikimet dhe ndryshimet e sugjeruara do të kenë efekt të pakët në shumicën e të rinjve me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta pasi që ata kurrë nuk do të arrijnë nivelin e duhur të ofruar të AAP, mirëpo do të përmbush mjaft mirë nevojat e tyre. Prandaj synimet 1 dhe 2 të politikës janë të lidhura me këto çështje.

Synimi 1 i politikës 1

Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta do të pajisen me shkollim fillor dhe shkollim të mesëm të ulët i cili do të përmbush nevojat e tyre specifike të mësimin kështu që ata të mund të përparojnë në mënyrë të suksesshme në programet akademike apo në programet e AAP.

Mësimdhënësit e specializuar do të kenë shkathtësitë, njohuritë dhe të kuptuarit për tu mundësuar atyre të zhvillojnë arsim të specializuar për ata të cilët kanë nevojë për atë arsim.

Formulimi i Zotimit 1 Do të ndërmerren veprime për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien në arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta në mënyrë që ta të përparojnë në mënyrë të suksesshme në arsimin dhe aftësimin e lartë të mesëm dhe profesional. Shkollat speciale do tu japin nxënësve të tyre përgatitjen me të mirë për jetën e tyre në të ardhmen dhe po ashtu të shërbejnë si resurse në sistemin e përgjithshëm të arsimit. Do të ndërmerren veprime për të përmirësuar arsimin para AAP të fëmijëve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta në mënyrë që të përgatiten më mirë për APP, kjo mund të përfshij:

- Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta të inkurajohen për të zhvilluar shkathtësitë e tyre të leximit dhe numërimit në nivelin me të lartë të mundshëm për ata, nga mosha më e hershme e arsyeshme dhe e mundshme;
- Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta të inkurajohen për të kuptuar se për çfarë ndihme dhe mbështetje kanë nevojë ata dhe të mësojnë se si të kërkojnë ato ndihma kur ata kanë nevojë për ato;

- Fëmijët të cilët janë të shurdhër apo dëgjojnë shumë pak të mësojnë gjuhën e shenjave sa më herët që është e mundshme, në mënyrë ideale të fillojnë nga mosha dy mujore kur janë ende bebe kur ' sytë filloj në të fokusohen;
- Gjuha e shenjave të jetë mesatare në udhëzime për fëmijët e shurdhër apo dëgjojnë shumë pak dhe ata të mësojnë gjuhën kryesore të udhëzimeve si gjuhë të dytë;
- Nëse sistemi i përgjithshëm komunikues funksionon, kjo duhet të përfshij gjuhën e plotë dhe të rrjedhshme të shenjave si dhe të folurit me buzë, leximin e buzëve, shprehjet e fytyrës dhe gjestet;
- Të gjithë mësimdhënësit e fëmijëve të shurdhër në shkolla speciale apo klasa të jenë të rrjedhshëm në gjuhën e shenjave;
- Fëmijët të cilët dëgjojnë pak të inkurajohen që ta përdorin të dëgjuarit sa më shumë që është e mundshme dhe të pajisen me ndihma të përshtatshme për dëgjim;
- Të gjithë fëmijët me vështirësi në të dëgjuar të mësojnë leximin nga buzët në mënyrë që të zëvendësojnë gjuhën e shenjave apo të dëgjuarit e tyre;
- Të gjithë fëmijët me vështirësi në të dëgjuar të pajisen me zhvillime të specializuara të gjuhës pasi që ata nuk janë në gjendje të zhvillojnë koncepte aq lehtë sa fëmijët me të dëgjuar të plotë;
- Të gjithë fëmijët me vështirësi në të dëgjuar të inkurajohen për përdorimin e zërit të tyre dhe të flasin pasi që kjo ju mundëson atyre komunikimin me njerëzit me dëgjim të rregullt;
- Fëmijët e verbër apo ata të cilët shohin shumë pak të inkurajohen për të hulumtuar botën që i rrethon duke përdorur shqisat e tyre të mbetura dhe të mësohen se si të lëvizin për rreth dhe se si të përdorin pajisjet dhe veglat në mënyrë të lirshme dhe të sigurt;
- Fëmijët e verbër apo ata të cilët shohin shumë pak, apo ata të cilët janë në gjendje e cila do tu shkaktoj verbërim duhet të mësohen të lexojnë dhe shkruajnë në Braille nga faza me e hershme e mundshme, në mënyrë ideale të fillohet në fazën para shkollore;
- Fëmijët të cilët kanë vështirësi në të pamur duhet të inkurajohen të përdorin sa më shumë syze dhe duhet

të kenë syze të përshtatshme dhe ndihma për shkurt pamësi siç janë zmadhuesit;

- Fëmijët të cilët kanë të pamur të mjaftueshëm duhet të mësojnë të lexojnë, shtypin, duke përdorur çfarëdo niveli dhe madhësi shkronjash të cilat ju përshtatet atyre;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara fizike duhet të kenë qasje në ndihmat, pamjet dhe ndihmën e duhur për tu mundësuar atyre të mësojnë në mënyrë efektive;
- Fëmijët me vështirësi specifike me orientim dhe radhitje të shkronjave, fjalëve dhe numrave (shpesh quhet disleksi) duhet tu mësohen strategjitë për tu ndihmuar atyre dhe tu mundësoj atyre përgjigjet verbale në vend të atyre me shkrim kur është e nevojshme;
- Fëmijët të cilët kanë çrregullime të spektrit të autizmit apo ata të cilët kanë vështirësi emocionale dhe në sjellje duhet tu mësohen strategjitë për të ndihmuar menaxhimin e sjelljes së tyre dhe duhet të bëhen ndryshime për tu mundësuar atyre përdorimin e strategjive, siç janë koha jashtë klasës, rutina e rregullt e parashikuar apo ikja nga kontakti ni afërt me të tjerët;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara të pa dallueshme apo vështirësi siç janë sëmundjet e zemrës, epilepsia, sëmundjet kronike apo sëmundjet shëndetësore apo diabeti duhet të mësojnë se si të kuptojnë se si ndikon tek ta gjendja e tyre, për çka kanë nevojë ata dhe se si duhet të reagojnë ata në rast emergjence.

Formulimi i Zotimit 2. Do të ndërmerren veprime për të rritur numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta të cilët nuk kanë vijuar asnjëherë mësimin apo kanë braktisur shkollën para përfundimit të shkollimit fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.

Veprimet që duhen ndërmarrë për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

- Analizat e kryera për të themeluar:
 - i. Sa fëmijë janë aktualisht nën moshën 16 vjeçare dhe nuk kanë vijuar asnjëherë shkollën, arsyet për këtë dhe çka do të jetë e nevojshme të arrihet që ata të vijnë në shkollimin.

ii. Sa fëmijë janë aktualisht nën moshën 16vjeçare që kanë braktisur shkollën para përfundimit të shkollimit fillor në mënyra tjera.

Të dhënat duhen përdorur pastaj si bazë për planifikimin dhe implementimin e ofrimeve për të përmbushur nevojat e fëmijëve të tillë me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta. Analizat e tilla do të kryhen në bashkëpunim me një apo më shumë OJQ, stafin e përfshirë në kujdesin shëndetësor dhe ndonjë staf tjetër relevant i cili i njeh familjarisht dhe të cilit i besojnë.

- Zhvillimi i njësive shkollore lëvizëse duhet të përfshij nxënësit për të cilët regjistrimi në shkollë është jo i mundshëm.
- Një kampanjë në vazhdimësi e medieve kombëtare duhet të filloj të ndryshoj qëndrimet e vjetra të publikut në lidhje me aftësitë e kufizuara dhe të nxis pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nëpër shkolla.
- Rritja e ofrimit të transportit për fëmijët të cilët do të ishin të suksesshëm në shkollë por nuk janë gjendje të ecin në distancat e njëjta me kolegët e tyre apo të përdorin transportin publik sikur kolegët e tyre për shkak të aftësive të tyre të kufizuara.

Veprimet që duhen ndërmarrë për të përmbushur zotimin dhe për të përmirësuar numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta të cilët përfundojnë arsimin e tyre bazë përfshin si në vijim:

- Drejtorët e shkollave duhet të ndërmarren veprime për të gjetur arsyen e mungesës nëse fëmijët mungojnë në shkollë për 5 ditë të njëpasnjëshme dhe të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të siguruar kthimin e nxënësit në shkollë sa më shpejt që të jetë e mundshme, gjasat me të mëdha janë që ata të mos kthehen në shkollë. Duhet mbajtur evidencë e cila tregon veprimet e ndërmarra për secilin nxënësi i cili mungon nga shkolla për më shumë se 5 ditë dhe rezultatet e veprimeve të ndërmarra.
- Një iniciativë e përbashkët e përhershme e ngritur për stafin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shëndetësisë, dhe Departamentit të

shërbimeve shoqërore të Ministrisë së Pushtetit Lokal, prindërit, OJQ-të dhe të tjerët për të identifikuar fëmijët të cilët braktisin shkollën apo që janë në rrezik të braktisjes së shkollës, të shqyrtohen arsyet se pse po e braktisin shkollën fëmijët dhe tu mundësohet atyre qëndrimi në shkollë apo kthimi i tyre në shkollë sa më shpejt që është e mundur.

- Ofrimi ekzistues i kujdesit dhe arsimit në fëmijërinë e hershme do të vazhdojë të forcohet nga MASHT dhe të shtrihet nga OJQ dhe sektori privat në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta të jenë me të përgatitur për shkollë, të kenë më shumë gjasa për sukses dhe të braktisin më pak shkollën.
- Të gjithë fëmijët e moshës parashkollore të cilët kanë aftësi të kufizuara apo të identifikohen si me nevoja të veçanta kanë qasje të plotë të lirë në ofrimet parashkollore pasi që kujdesi dhe arsimitimi në fëmijëri është i rëndësishëm së lartë për fëmijët nga grupet e jo favorizuara.
- Zhvillimi i ofrimit të Punëtorëve për Mbështetje Mësimore (PMM) për të ofruar shërbime mbështetëse për ata të cilët nuk arrijnë sukses në shkollë apo për ata të cilët më shumë sukses me mbështetje shtesë. Roli i PMM do të zhvillohet si prioritet si një mjet ndihmës kyç në arritjet e arsimit gjithëpërfshirës.

Synimi 2 i politikës

Të gjithë të rinjtë me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta do të kenë qasje në APP përfshirë kualifikimet e standardeve të njëjta sikur kolegët e tyre për përgatitjen e tyre për punë në fushën e tyre të preferuar profesionale. Kjo do të mbështetet përmes ndryshimit të qëndrimit, modifikimit e përshtatshëm të metodave dhe resurseve të mësimdhënies, përdorimi efikas i ndihmave dhe zbatimeve përfshirë përdorimin e informatave dhe teknologjisë komunikuese dhe përmes ofrimit të ndryshimeve të nevojshme ndaj ambientit. Vlerësimet duhen modifikuar për tu përshtatur nevojave të kandidatëve me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta pa pasur nevojë të ndryshohen standardeve.

Këta individë me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta të cilët nuk kanë në gjendje të qasen kurrikullit të rregullt të plotë apo kualifikimit të plotë në fushat e preferuara profesionale, do të jenë në gjendje të fitojnë kualifikim të pjesshëm përmes sistemit modular të AAP për tu mundësuar atyre të arrijnë brenda kufijve të aftësive të tyre të kufizuara.

Formulimi i Zotimit 3. Do të ndërmerren veprime për të rritur numrin e të rinjve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta të cilët regjistrohen dhe përfundojnë në mënyrë të suksesshme arsimin dhe aftësimin profesional, duke përfshirë nivelin 1 dhe të AAP dhe zhvillimin e ofrimit të plotë modular të AAP në Kosovë.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

- Aftësimi para shërbimit dhe në shërbim i mësimdhënësve të AAP ka nevojë për ndryshime të mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, në rast nevojë siç është paraqitur në veglat 2-9 të Pakon e veglave;
- Menaxhimi i mësimdhënësve të AAP për tu siguruar se ata implementojnë ndryshimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, në rast nevojë siç është paraqitur në veglat 2-9 të Pakon e veglave;
- Do të zhvillohet aftësimi për themelimin dhe mirëmbajtjen e biznesit të vogël për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara të cilët nuk mund të gjejnë punë me mënyra të tjera, apo do të preferonin të vet punësohen;
- AAP për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe të shqisave fokusohen në përdorimin e teknologjisë moderne për tu mundësuar atyre të punësohen apo vet punësohen;
- Nivelet 1 dhe 2 janë zhvilluar si dhe programet aftësuese profesionale praktike për të përgatitur të rinjtë dhe të rriturit me vështirësi intelektuale për punë rutinore.
- Shtrirja e rolit të PPM në AAP.

Formulimi i Zotimit 5 Do të ndërmerren veprime për tu siguruar se ndryshimet korrekte janë bërë në vlerësime për kandidatët me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta për të pasur sukses në demonstrimin e shkathtësive, njohurive dhe kompetencave të tyre.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

- Aftësimi para shërbimit dhe në shërbim i mësimdhënësve dhe vlerësuesve të AAP ka nevojë për ndryshime të vlerësimit për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, në rast nevoje siç është paraqitur në veglat 10-12 të Pakos së veglave;
- Menaxhimi i mësimdhënësve dhe vlerësuesve të AAP për tu siguruar se ata implementojnë ndryshimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, në rast nevoje siç është paraqitur në veglat 10-12 të Pakos së veglave

Formulimi i Zotimit 6 Do të ndërmerren veprime për monitorimin e arritjeve të kualifikimeve nga personat me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta dhe siguron se çfarëdo modifikimi i kryer për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe ndryshime në vlerësim standardet që ata arrijnë janë të njëjta me ato të kolegëve të tyre.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

- Trajnimi i inspektorëve në monitorimin e arritjeve të kualifikimeve nga personat me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta dhe siguron se çfarëdo modifikimi i kryer për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe ndryshime në vlerësim standardet që ata arrijnë janë të njëjta me ato të kolegëve të tyre.
- Mbledhja e të dhënave të regjistrimit, vijueshmërisë, nivelet e kompletimit dhe arritshmërisë së nxënësve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta duhet të përcaktohet niveli i tyre ti suksesit në aspektin e promovimit të përmirësimeve vit pas viti në nivelet e suksesit të tyre.

Synimi 3 i politikës

Kosova do të zhvilloj një shërbim koherent gjithëpërfshirës të AAP i cili përmbush nevojat e me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta, kërkesat kombëtare dhe në përputhje me praktikën me të mirë ndërkombëtare.

Formulimi i Zotimit 10. Mekanizimi duhet të vendoset për të harmonizuar planifikimin relevant, krijimin e politikave, zhvillimin dhe dhënien e shërbimeve në mënyrë që sistemi arsimor Kosovar mund të ofroj një shërbim gjithëpërfshirës i cili përmbush kërkesat kombëtare dhe është në pajtim me praktikën me të mirë ndërkombëtare.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

- Krijimi i task forcës së një ndër-Ministrie për të siguruar harmonizimin e planifikimit relevant, krijimin e politikave, zhvillimin dhe dhënien e shërbimeve në mënyrë që sistemi i arsimit në Kosovë mund të ofrojnjë një shërbim gjithëpërfshirës të AAP i cili përmbush nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta, kërkesat kombëtare dhe në pajtim me praktikën me të mirë ndërkombëtare;
- Ngritja e shkathtësive të inspektorëve në mënyrë që të bëjnë gjykime të drejta në lidhje me nivelin që ofruesit e AAP ju ofrojnë nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta për të mësuar në mënyrë efektive dhe të fitojnë kualifikimet relevante në profilet e dhura profesionale;
- Të gjitha ministritë qeveritare të inkurajohen për të shqyrtuar politikat dhe praktikat e tyre për tu siguruar se janë duke kontribuar për një sistem arsimor gjithëpërfshirës të AAP dhe jo pa dashje të veprojnë për përjashtimin e tyre.
- Të gjitha OJQ dhe donatorët të inkurajohen për të shqyrtuar politikat dhe praktikat e tyre për tu siguruar se janë duke kontribuar për një sistem arsimor gjithëpërfshirës të AAP dhe jo pa dashje të veprojnë për përjashtimin e tyre. Ata po ashtu do të inkurajohen që të shtyjnë përpara sugjerimet se si mund të kontribuojnë më tutje.

- Të gjithë ofruesit relevant privat të AAP dhe shërbimeve në lidhje me punësim të inkurajohen të mënjanojnë praktikat diskriminuese dhe përjashtuese.

Synimi 4 i Politikës

Mësimdhënësit e AAP do të kenë shkathtësi, njohuri dhe të kuptuar dhe resurset dhe shërbimet mbështetëse për tu mundësuar atyre të bëjnë modifikime efektive për mësimdhënie dhe mësimnxënie për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të ndryshme dhe me aftësi të ndryshme të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta kështu që ata të mund të mësojnë në mënyrë efektive. Mësimdhënësit dhe vlerësuesit do të kenë shkathtësi, njohuri dhe të kuptuar dhe resurset dhe shërbimet mbështetëse për tu mundësuar atyre të bëjnë modifikime efektive për vlerësime pa pasur nevojë të ndryshohen standardet.

Formulimi i zotimit 4 Do të ndërmerren veprime përmes para shërbimit dhe gjatë shërbimit për tu siguruar se mësimdhënësit janë efikas në aftësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, për ti mësuar programet e AAP dhe të arrijnë shkathtësi dhe kualifikime relevante.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

Një program i përsëritur i aftësimit në shërbim të mësimdhënësve të AAP, të zhvilluara përmes strukturës ekzistuese do të zhvillohen dhe implementohen për tu dhënë mësimdhënësve shkathtësi të përmirësuar në mësimdhënie e rangut të plotë të nxënësve në klasat e tyre, përfshirë ata me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta.

Formulimi i Zotimit 7 Do të ndërmerren veprime për të përmirësuar qasjen e ofruesve të AAP në një rang me të gjerë të kualitetit të mirë të ndihmave të mësimdhënies dhe resurseve të mësimnxënies të përshtatshme me numrin dhe nevojat specifike të nxënësve me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

- Zhvillimi i një rangu resurseve bazë të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe mënyrat e këshillave për nxënësit e AAP me aftësi të kufizuara apo vështirësi specifike, siç janë vështirësitë në dëgjim, vështirësitë në pamur, vështirësitë intelektuale, vështirësitë gjuhësore apo vështirësitë emocionale apo në sjellje, të cilat duhet të jenë në dispozicion në të gjitha shkollat dhe ofruesit privat;
- Aftësimi para shërbimit dhe në shërbim i mësimdhënësve duke përfshirë përdorimin e këtyre metodave si dhe aftësimin për zhvillimin e resurseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyrë që mësimdhënësit e AAP të jenë në gjendje të krijojnë resurset e tyre shtesë në përmbushjen e nevojave të nxënësve që ata mësojnë;
- Krijimi i qendrave të resurseve komunale të cilat përmbajnë një grup resurseve për lehtësimin e mësimnxënies për nxënësit me aftësi të ndryshme të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta për mësimin e tyre në profilet ndryshme profesionale;
- Nxitja e raporteve midis OJQ relevante të cilat kanë qasje në informatat të cilat do të ishin të dobishme për nxënësit me aftësi të veçanta të kufizuara dhe me njohuri se si mund të arrihen ato;
- Zhvillimi i rolit të shkollave speciale në rolin e tyre paralel të qendrave të resurseve dhe pronarëve dhe shpërndarësve të pajisjeve të specializuara dhe resurseve mësimore.

Formulimi i Zotimit 8. Do të ndërmerren veprime për të zhvilluar shërbime mbështetëse të specializuara të cilat do të ofrojnë informata, shkathtësi dhe rekomandime për ofruesit e AAP dhe mësimdhënësit e AAP me zëvendësuesit e nevojshëm si jo specialist për mësimin dhe vlerësimin e aftësive të kufizuara dhe nevojave të veçanta në mënyrë efektive.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

Krijimi i një shërbimi këshillues apo ekipi të resurseve të specializuara, duke përdorur mësimdhënësit e shkathtësuar dhe me përvojë të AAP të cilët janë aftësuar për mbështetjen e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta, të cilët do të mbështesin mësimdhënësit e AAP në modifikimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe të bëjnë

ndryshimet e duhura për tu mundësuar nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta që të kenë sukses në arritjen e kualifikimeve profesionale; Zhvillimi i rolit të shkollave speciale në rolin e tyre paralel të qendrave të resurseve dhe pronarëve dhe përhapësve të shkathtësive të specializuara.

Qëllimi i Politikës 5

Ofruesit profesional do të ofrojnë institucione mbështetëse dhe humane të cilat do të mbështesin të gjithë nxënësit e tyre dhe do të vlerësojnë arritjet e tyre kështu që nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta do të vijojnë mësimin në mënyrë të rregullt, të punojnë me zell në studimet e tyre dhe arrijnë kualifikimet të cilat do tu mundësojnë atyre hyrjen në tregun e punës.

Formulimi i Zotimit 9. Do të ndërmerren veprime për tu siguruar se ofruesit e AAP të krijojnë institucione mbështetëse dhe humane të cilat mbështesin të gjithë nxënësit e tyre.

Veprimet e ndërmarra për të përmbushur këtë zotim mund të përfshijnë si në vijim:

- Zhvillimi i kodit të sjelljes për ofruesit e AAP për tu siguruar se menaxherët dhe mësimdhënësit janë të njohur me standardet e sjelljes të cilat priten nga ata sa i përket arsimimit të nxënësve me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta, përfshirë sjelljen e tyre ndaj nxënësve. Duhet ndërmarre masa nëse ofruesit nuk i përmbahen kodit të sjelljes;

- Ofruesit e AAP të inkurajohen për të zhvilluar ofrimin pastoral në shkollat apo programet e tyre dhe të sigurohen se nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta marrin mbështetjen adekuate pastorale;
- Ofruesit e AAP të inkurajohen për tu siguruar se ndërtesa e shkollës është mirëseardhëse për të gjithë. Nëse është e nevojshme të ketë qasje për nxënësit me aftësi të kufizuara, siç janë ata me vështirësi lëvizjeje, shirita që shihen nga largësia për ata me vështirësi në të pamur, dhe shenja fotografish për ata të cilët kanë aftësi të kufizuara intelektuale;
- Të gjithë nxënësit e rinj me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta të kenë orientim të nevojshëm për të shkuar në shkollë apo në premisat e ofruesve të AAP, duhet tu përmbushen pritjet dhe duhet ofruar mbështetje;
- Zhvillimi i një 'Buddy System – Sistem shoku' në mënyrë që nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta të cilët kanë tani shokë në shkollat e AAP, nëse ata dëshirojnë mund të udhëtojnë me shokët e tyre në mënyrë që të përfshihen në aktivitetet jo formale;
- Shkollat e AAP dhe ofruesit privat të inkurajohen për të zhvilluar politika dhe praktika jo detyruese për të siguruar se nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta me nevoja të veçanta arsimore të mos detyrohen apo ngacmohen nga të tjerët.

UDHËZIME PËR IMPLEMENTIM

Pas miratimit dhe pranimit të politikës sa i përket nxënësve të AAP me aftësi të kufizuara apo nevoja tjera të veçanta atëherë duhet të përpilohet një plan strategjik apo veprues nga ana e të gjitha palëve të interesit në nivel të lartë i cili përcakton të gjitha prioritetet për të gjitha aktivitetet të cilat do të përmbushin formulimet e zotimeve dhe të arrijnë qëllimet e politikës. Ministritë individuale, departamentet dhe të organizatat tjera duhet të planifikojnë aktivitetet e tyre për të përmbushur kërkesat e planit të përgjithshëm të veprimit. Veprimeve duhet tu caktohet prioritet si në vijim:

- Atyre që duhen kryer gjatë vitit të ardhshëm shkollor
- Atyre që duhen kryer gjatë dy viteve pas tij
- Atyre që duhen kryer gjatë pesë viteve të ardhshme
- Atyre që duhen kryer pastaj

Kur të caktohen prioritetet, përgjegjësitë duhet caktuar kështu që një person individual ka përgjegjësi për udhëheqjen e aktivitetit të caktuar me një afat kohor në të cilin duhet filluar dhe përfunduar aktiviteti.

Individët përgjegjës duhet të jenë zyrtar të Ministrive apo Divizioneve relevante me të cilët aktiviteti ka të bëjë. Shumë aktivitete kanë nevojë për shumë vite për tu përfunduar dhe duhet të kenë data për arritje të caktut të përkohshëm për të demonstruar aktivitetin në vazhdimësi.

Disa aktivitete mund të kryhen me pak shpenzime apo pa shpenzime shtesë, të tjerat kërkojnë llokim buxheti një vit para se aktiviteti duhet të zhvillohet. Koordinimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve duhet ti lihen zyrtarit të nivelit të lartë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë .

Raportet mujore duhen bërë për Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë mbi progresin e arritjes së implementimit të sistemit gjithëpërfshirës të AAP.

PAKOJA E VEGLAVE PËR MODIFIKIME NË MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE, MODIFIKIMET NË VLERËSIM PËR TU PËRSHTATUR NXËNËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE NEVOJA TË VEÇANTA

Përmbajtje

Seksioni 1

Veglat për qasje në arsimin dhe aftësimin profesional për nxënës me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta përmes modifikimeve në mësimdhënie dhe mësimnxënie:

- Lista kontrolluese për krijimin e bazave të suksesit në APP për nxënës me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta.

Modifikimet për mësimdhënie dhe mësimnxënie për nxënësit me:

- Vështirësi në mësimnxënie
- Aftësi të kufizuara intelektuale
- Aftësi të kufizuara fizike
- Vështirësi në të dëgjuar
- Vështirësi në të pamur
- Autizëm
- Vështirësi emocionale dhe në sjellje
- Aftësi të kufizuara apo vështirësi të pa dallueshme

Seksioni 2

Veglat për adaptimin e vlerësimit për përshtatjen e kandidatëve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta.

- Ndryshimet që duhen marrë parasysh në vlerësim
- Racionalja për krijimin e ndryshimeve në vlerësim

- Forma e planifikimit – krijimi i ndryshimeve për kandidatët me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta

Këto vegla janë dizajnuar për përdorim për:

- Zhvillimin e shkathtësive në arsimin fillor dhe atë të ulët të mesëm me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta për të pasur sukses në AAP;
- Zhvillimi i modifikimeve në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe ndryshimet në sistemin e AAP në Kosovë;
- Zhvillimi i programeve të nivelit 1 dhe 2 në Kosovë;
- Planifikimi dhe implementimi e aftësimin para dhe në shërbim për mësimdhënësit e AAP sa i përket nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta;
- Përdorimi nga ofruesit e AAP në krijimin e ofrimit për nxënës me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta ;
- Përdorimi nga ana e mësimdhënësve individual në punën e tyre me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta;
- Përdorimi nga organizatat tjera qeveritare dhe jo qeveritare të cilat ofrojnë shërbime dhe pajisje për tu mundësuar sukses në AAP nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta.

SEKSIONI 1: OFRIMI I QASJËS NË ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE NEVOJA TJERA TË VEÇANTA APËRMES MODIFIKIMEVE NË MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE

Veçlja 1. Lista kontrolluese për krijimin e suksesit në APP për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta

Në mënyrë që nxënësit të përfitojnë plotësisht nga arsimi i mesëm i lartë, përfshirë arsimin profesional është vitale që ata të zhvillojnë të gjitha shkathtësitë që janë mësuar në nivelin e arimit parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët në maksimumin e mundshëm për secilin individ.

- Kjo listë kontrolluese përcakton të drejtat themelore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta në para arsimin e AAP.

Në veçanti:

- Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta duhet të vijnë në mësimin dhe të kenë përmbushur nevojat e tyre personale dhe arsimore në nivelin e arimit parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët, ose në ambiente të specializuara apo të përgjithshme aty ku ata janë në gjendje të mësojnë me së miri;
- Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta të inkurajohen për të zhvilluar shkathtësitë e tyre të leximit dhe numërimit në nivelin më të lartë të mundshëm për ata, nga mosha më e hershme e arsyeshme dhe e mundshme;
- Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta të inkurajohen për të kuptuar se për çfarë ndihme dhe mbështetje kanë nevojë ata dhe të mësojnë se si të kërkojnë ato ndihma kur ata kanë nevojë për ato;

- Fëmijët të cilët janë të shurdhër apo dëgjojnë shumë pak të mësojnë gjuhën e shenjave sa më herët që është e mundshme, në mënyrë ideale të fillojnë nga mosha dy mujore kur janë ende bebe kur ' sytë filloj në të fokusohen;
- Gjuha e shenjave të jetë mesatare në udhëzime për fëmijët e shurdhër apo dëgjojnë shumë pak dhe ata të mësojnë gjuhën kryesore të udhëzimeve si gjuhë të dytë;
- Nëse sistemi e përgjithshëm komunikues funksionon, kjo duhet të përfshij gjuhën e plotë dhe të rrjedhshme të shenjave si dhe të folurit me buzë, leximin e buzëve, shprehjet e fytyrës dhe gjetet;
- Të gjithë mësimitdhënësit e fëmijëve të shurdhër në shkolla speciale apo klasa të jenë të rrjedhshëm në gjuhën e shenjave;
- Fëmijët të cilët dëgjojnë pak të inkurajohen që ta përdorin të dëgjuarit sa më shumë që është e mundshme dhe të pajisen me ndihma të përshtatshme për dëgjim;
- Të gjithë fëmijët me vështirësi në të dëgjuar të mësojnë leximin nga buzët në mënyrë që të zëvendësojnë gjuhën e shenjave apo të dëgjuarit e tyre;
- Të gjithë fëmijët me vështirësi në të dëgjuar të pajisen me zhvillime të specializuara të gjuhës pasi që ata nuk janë në gjendje të zhvillojnë koncepte aq lehtë sa fëmijët me të dëgjuar të plotë;
- Të gjithë fëmijët me vështirësi në të dëgjuar të inkurajohen për përdorimin e zërit të tyre dhe të flasin pasi që kjo ju mundëson atyre komunikimin me njerëzit me dëgjim të rregullt.

- Fëmijët e verbër apo ata të cilët shohin shumë pak të inkurajohen për të hulumtuar botën që i rrethon duke përdorur shqisat e tyre të mbetura dhe të mësohen se si të lëvizin për rreth dhe se si të përdorin pajisjet dhe veglat në mënyrë të lirshme dhe të sigurt;
- Fëmijët e verbër apo ata të cilët shohin shumë pak, apo ata të cilët janë në gjendje e cila do tu shkaktoj verbërim duhet të mësohen të lexojnë dhe shkruajnë në Braille nga faza me e hershme e mundshme, në mënyrë ideale të fillohet në fazën para shkollorë;
- Fëmijët të cilët kanë vështirësi në të pamur duhet të inkurajohen të përdorin sa më shumë syze dhe duhet të kenë syze të përshtatshme dhe ndihma për shkurt pamësi siç janë zmadhuesit.
- Fëmijët të cilët kanë të pamur të mjaftueshëm duhet të mësojnë të lexojnë, shtypin, duke përdorur çfarëdo niveli dhe madhësi shkronjash të cilat ju përshtatet atyre;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara fizike duhet të kenë qasje në ndihmat, pamjet dhe ndihmën e duhur për tu mundësuar atyre të mësojnë në mënyrë efektive;
- Fëmijët me vështirësi specifike me orientim dhe radhitje të shkronjave, fjalëve dhe numrave (shpesh quhet disleksi) duhet tu mësohen strategjitë për tu ndihmuar atyre dhe tu mundësoj atyre përgjigjet verbale në vend të atyre me shkrim kur është e nevojshme;
- Fëmijët të cilët kanë çrregullime të spektrit të autizmit apo ata të cilët kanë vështirësi emocionale dhe në sjellje duhet tu mësohen strategjitë për të ndihmuar menaxhimin e sjelljes së tyre dhe duhet të bëhen ndryshime për tu mundësuar atyre përdorimin e strategjive, siç janë koha jashtë klasës, rutina e rregullt e parashikuar apo ikja nga kontakti në afërt me të tjerët;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara të pa dallueshme apo vështirësi siç janë sëmundjet e zemrës, epilepsia, sëmundjet kronike apo sëmundjet shëndetësore apo diabeti duhet të mësojnë se si të kuptojnë se si ndikon tek ta gjendja e tyre, për çka kanë nevojë ata dhe se si duhet të reagojnë ata në rast emergjence.

Vegla 2. Modifikimet për mësimdhënien e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja tjera të veçanta në ofrimin e AAP.

Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie janë të vetëdijshëm dhe shpesh turpërohen nga vështirësitë e tyre dhe përpiqen ti fshehin ato. Kjo në veçanti është prezent tek të rinjtë dhe të rriturit të cilët me vite nuk kanë pasur ndjenjën e suksesit në mësimnxënie por janë të vetëdijshëm se disa nga shkathtësitë e tyre akademike janë të nivelit normal të fëmijëve të rinj. Mësimdhënësit duhet të sigurohen që ata të mos sillen në mënyrë që të fyjnë shokët e tyre të klasës apo të fyhen nga shokët e klasës së tyre. Nxënësit e ngadalshëm nuk janë dembel apo të çmendur. Vetëm është e vështirë për ata që të mësojnë me kolegët e tyre dhe ata nuk mund të jenë në gjendje të kenë progresin e njëjtë.

Nëse nxënësi ka vështirësi me lexim apo shkrim duet pasur parasysh:

- Sigurimin që nxënësit vijojnë kurset të cilat janë shumë praktike dhe kërkojnë më pak lexim dhe mësim;
- Të kenë nxënës të tjerë që ju lexojnë udhëzimet me zë të lartë;
- Lejojnë që nxënësit të japin përgjigje verbale në vend të atyre me shkrim;
- Të krijojnë fleta pune të thjeshta apo lista detyrash të cilat mund të kuptohen nga nxënësit;
- Të lejojnë që nxënësi të përfundoj kursin brenda një periudhe me të gjatë kohore se sa ajo e zakonshme për kursin.

Personat me disleksi kanë mesataren apo mbi mesataren e inteligjencës por kanë vështirësi të veçanta me perceptimin, radhitjen, orientimin dhe përcjelljen e mësimin. Kjo ju shkakton atyre vështirësi të mëdha pasi që këto janë shkathtësi vitale për lexim, shqiptim dhe matematikë pasi që radhitja e shkronjave, fjalëve dhe numrave ka ndryshim të madh - 573 nuk është i njëjtë me 753 apo 357 dhe pot nuk është e njëjtë me top. Ai apo ajo mund të ketë vështirësi për përcjelljen e udhëzimeve – më shumë se një herë, hutinë midis të djathtas dhe majtas, hutinë me shkronja të ngjashme me orientim të ndryshëm siç janë m/w, n/u, p/q, b/d.

Këto vështirësi shpijnë ne një progres të ngadalshëm të leximit kur nxënësi heziton veçanërisht kur kemi të bëjnë me leximin me zë të lartë apo ata mund ta humbin radhitjen e tyre duke lexuar rreshtin e njëjtë dy here apo ta harroj një rresht. Ngadalësia dhe vështirësitë në lexim kanë domethënien se nxënësit shpesh kanë probleme me të kuptuarit apo të mbajturit mend se çka është lexuar.

Puna me shkrim mund të rezultojë me shkrim të dobët dhe vizatime dhe diagrame të çrregullta dhe të pa kompletuara.

Disa nxënës me disleksi vijnë në përfundim se leximi i tyre përmirësohet nëse ata përdorin shtresa plastike transparente për të mbuluar fletën.

Nëse keni nxënës me këto vështirësi merrni parasysh:

- Mundësinë që nxënësi të diktoj apo inçizoj përgjigjet në vend të shkrimit të përgjigjes;
- Incizimin e udhëzimeve në mënyrë që nxënësi të mund ti dëgjoj ato disa here;
- Mundësinë që nxënësi të incizoj ligjëratat dhe diskutimet në vend të mbajtjes së shënimeve
- Tu jepet kohë shtesë për detyra;
- Sigurohen se nxënësi mund ta përdorë korrigjuesin automatik dhe lehtësimin e qendrës së qasjes i cili mund të vendoset në Control Panel të kompjuterit
- Inkurajimin e nxënësve për të formuar mini fjalorin e tyre të fjalëve kyçe dhe të fjalëve me përdorim të shpeshtë në kursin që ata ndjekin në mënyrë që të mund të referohen në korrigjuesin korrekt.

Mos e detyroni nxënësin dhe mos i zbrisni notat për gabime në shkrim apo punën e prezantuar pasi që kjo është dekurajuese për nxënësit të cilët janë përpjekur shumë por nuk mund të arrijnë standardet që ata donë. Notoni për përmbajtje dhe jo për prezantime.

Nxënësit të cilët kanë vështirësi në mësimnxënien për shkak të problemeve shëndetësore fizike apo mendore kanë nevojë për më shumë kohë se sa nxënësit tjerë për shkak të mungesës dhe mungesës së qëndrueshmërisë së tyre. Ata duhet të dekurajohen nga përcaktimi i tyre për kurset që kanë kërkesa të konsiderueshme fizike apo kërkojnë mësim në objekte të cilat do ta dëmtojnë shëndetin e tyre.

Do të ishte shumë mirë për këta nxënës që të zhvillojnë AAP në nivelin 1 dhe 2. ata ose mund të bëjnë progres në nivelin 3 dhe 4 ose mund të kërkojnë punë pas kualifikimi të AAP më pak të avancuar. Është e rëndësishme të krijohet një listë kontrolluese për modifikim të mësimdhënies dhe mësimnxënies, e cila duhet të diskutohet me nxënësit për të drejtuar modifikimet për mësimdhënien dhe mësimnxënien për secilin individ me vështirësi në të mësuar. Merrni reagime nga nxënësit në çdo rast si një tregues i nivelit të tyre të të kuptuarit.

Vegla 3. Zhvillimi i qasjes së AAP për nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale

Një aftësi e kufizuar intelektuale do të thotë se individ ka kapacitet të kufizuar për të mësuar dhe mund të mos jetë në gjendje të funksionoj në mënyrë të njëjtë prej të rriturit.

Momentalisht në Kosovë AAP duket të jetë e kufizuar për nxënësit me aftësi të lehta të kufizuara intelektuale që të mund të mësojnë shkathtësi praktike dhe të kenë sukses në punësimin rutinë pa shkathtësi të larta. Nxënësit kanë nevojë për program praktik i cili do tu mësojë atyre shkathtësitë që ju duhen atyre për tu pranuar në punë. Është e rëndësishme që të zhvillohen nivelet 1 dhe 2 të AAP për tu mundësuar atyre të mësojnë shkathtësitë për punësim dhe të kenë shanse për të gjetur punë. Kujdesi ndaj kafshëve, bimëve apo tokës janë shpesh fusha të nevojshme për tu dhënë prioritet në zhvillimin e programeve të nivelit 1.

Në nivelin 1 fokusi duhet të përqendrohet në shkathtësitë për punësim brenda kontekstit profesional praktik për të përgatitur nxënësit për të kryer punë rutinore dhe të parashikuara.

- Çka pritet në industri
- Detyrat rutinore
- Përmbajtja e rregullave dhe udhëzimeve
- Mbajtja e kohës dhe besueshmëria
- Identifikimi se ku është problemi dhe njohuria se si të veprohet me të
- Siguria në punë
- Puna me kolegët dhe publikun (nëse aplikohet)

Për shumë nxënës me vështirësi intelektuale ky mund të jetë niveli me i lartë i kualifikimit të AAP të cilin ata janë në gjendje ta arrijnë.

Në nivelin 2 , kompetenca përfshin zbatimin e njohurive në një rang të lartë të aktiviteteve të punës të kryera në kontekste të ndryshme. Bashkëpunimi me të tjerët, ndoshta përmes anëtarësimit ne një grup punues apo ekip shpesh është një kërkese. Disa nxënës me vështirësi të lehta intelektuale mund të arrijnë këtë nivel.

Për nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale për të cilët niveli 1 do të jetë shumë sfidues, ofrimi po ashtu mund të bëhet në nivelin hyrës ku fokusohen shkathtësitë për jetën e përditshme të cilat mund të jenë një përgatitje për programin e nivelit 1.

Vegla 4. Modifikimet për mësimdhënien e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike

Shumica e personave me aftësi të kufizuara nuk përdorin karrocë ndihmese për ecje dhe shumica nuk do të kenë nevojë për modifikime në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe vetëm disa modifikime në ambient. Edhe pse disa persona me aftësi të kufizuara do të duken sikur të kenë aftësi të kufizuara intelektuale, shumica e tyre brenda rangut normal të aftësive disa nga ta janë të njëjtë sikur popullata në përgjithësi me inteligjencë të shkëlqyeshme.

Personat me paralizë cerebrale ballafaqohen me vështirësi të veçanta për shkak të pa aftësisë së tyre për të kontrolluar muskujt dhe lëvizjet e tyre dh vështirësitë të cilat i shkaktojnë këto në shqiptim dhe gëlltitje do të thotë se ata duken më pak inteligjent se sa që janë ata. Rreth 60% e personave me paralizë cerebrale kanë inteligjencë normale apo mbi normalen. Aftësia e tyre për të shprehur inteligjencën e tyre mund të jetë e kufizuar për shkak të vështirësive në komunikim. Ata gjithashtu mund të kenë vështirësi me të shkruar dhe manipulim të materialeve dhe pajisjeve për shkak të muskujve të tyre të dobët apo lëvizjeve të pa kontrolluara.

Kur pyetet një student për tu përgjigjur ne një pyetje, lejoni atij shumë kohë për tu përgjigjur nëse nxënësi ka vështirësi ne të folur.

Nëse nxënësi ka vështirësi me mbajtjen e lapsit apo kimikut apo vështirësi me shpejtësi në të shkruar atëherë duhet marrë parasysh:

- Kohë shtesë nëse vështirësia nuk është e madhe;
- Ti lejohet nxënësit të diktoj apo incizoj përgjigjet dhe detyrat në vend që ti shkruaj ato përgjigje;
- Sigurimin se nxënësi mund të përdor kompjuterin, ndoshta me ndihmën e Qendrës për Qasje të lehtë e cila mund të vendoset në Control panel.

Disa aftësi të kufizuara fizike nënkuptojnë se nxënësi ka nevojë për adaptim special të mobileve apo pajisjeve për të ndjerë rehat dhe komod në ambientin e mësimi apo për të kryer punën e tyre në mënyrë efektive. Kjo duhet të ofrohet nga agjensionet tjera por për shkak se ambienti në AAP do të jetë ndryshe nga klasat e zakonshme, disa pajisje të cilat nxënësi i ka përdorur paraprakisht mund të kenë nevojë për ri vlerësim. Publikimet e personave të parëndësishëm janë të thjeshta për tu mbajtur të hapura dhe mund të jenë të lehta për disa persona për tu trajtuar.

Vegla 5. Modifikimi për mësimdhënien e nxënësve të cilët janë të shurdhër apo kanë vështirësi në të dëgjuar

Shumica e personave me vështirësi ne të dëgjuar nuk janë krejtësisht të shurdhër. Ata të cilët janë ne atë gjendje duhet të jenë të rrjedhshëm në gjuhën e shenjave para se ata të arrijnë nivelin e AAP dhe duhet tu ofrohet një interpretues i gjuhës së shenjave kur të regjistrohen ata në programin e përgjithshëm.

Nëse nxënësi përdor interpretues:

- Duhet folur direkt me nxënësin e jo me përkthyesin.
- Gjuha e shenjave mund të duket penguese në fillim por ju dhe nxënësit tjerë do të mësoheni shpejt me prezencën e interpretuesit.
- Jepni nxënësit dhe interpretuesit materialin e ligjëratave apo materialeve me shkrim paraprakisht, në mënyrë që ata të familjarizohen me fjalorin e ri teknik.
- Ofroni skripte apo video dhe media laser nëse ekziston mundësia për interpretuesin dhe nxënësin me aftësi të kufizuara në dëgjim.

- Interpretuesi nuk duhet përgjigjur pyetjeve ne lidhje me mësim nga nxënësi me vështirësi ne të dëgjuar. Nxënësi duhet ti drejtoj gjithë pyetjet në lidhje me mësim tek instruktori.
- Interpretuesi duhet të qëndroj afër dërrasës së zezë e cila përdoret nga instruktori, në mënyrë qe ti lejoj nxënësit qe në mënyrë simulantë të shohin shenjat dhe të shkruarit në dërrasë të zezë.

Të gjitha strategjitë e cekura më poshtë do të funksionojnë për shumicën e nxënësve por shkalla e vështirësisë dhe trajnimi paraprak i nxënësit do të ndikoj në përdorueshmërinë e strategjive të ndryshme.

- Gjatë komunikimit gjithmonë kthehuni me fytyrë nga nxënësi me vështirësi ne të dëgjuar.
 - Shprehjet e fytyrës, gjetet dhe gjuha e trupit do të ndihmojnë përcjelljen e mesazhit tuaj.
 - Nxitni vëmendjen e nxënësit me vështirësi ne të dëgjuar para se të filloni të flisni.
 - Nëse nuk është i kthyer me fytyrë nga ju nxënësi me vështirësi ne të dëgjuar atëherë prekni lehtë nxënësin në krah apo dorë për ti treguar atij se ju dëshironi i të flisni me të.
 - Mos u alarmoni nëse nxënësi nuk ju kupton juve apo ju nuk mund ta kuptoni atë. Në përgjithësi ju do të adaptoheni me këtë me njëri tjetrin.
 - Përsëritni fjalët e reja në kontekste të ndryshme.
 - Radhitni temat në mënyrë qe të kenë lidhje me atë çka është mësuar me parë.
 - Përdorimi i ndihmave për të pamur është me e dobishmja pasi qe të pamurit është mënyra primare e nxënësit për të marrë informacionet.
 - Përdorini lajmërime me shkrim (detyra, afate, data provimesh, ndryshime në orarin e klasës, datat e rasteve speciale, etj.).
 - Ofroni nxënësit një plan paraprakisht në lidhje me mësimin/aktivitetet, po ashtu shënioni pritjet tuaja.
 - Shkruani të gjitha detyrat e shtëpisë, udhëzimet në klasë, dhe ndryshimet e procedurave shkruani në dërrasë të zezë.
 - Përdorni filma të titulluar, video, dhe disqe laserike.
 - Bëni shënime në dërrasë të zezë të lexueshme.
 - Mos flisni gjatë shkrimit në dërrasë të zezë.
- Eliminoni zhurmën në prapavijë. Zërat qe duken si të zakonshëm dhe normalisht injorohen nga individët qe dëgjojnë, ata përforcohen me ndihma për dëgjim dhe ndërhyjnë në komunikimin e personit i cili ka vështirësi në dëgjim.
 - Krijoni bashkë me nxënësit një proceduar për raste emergjente. Për shembull në rast zjarri mësimdhënësi do të shënoj në dërrasë të zezë 'zjarri – dilni nga dera e pasme.' (gjithashtu nëse keni student me gjuhë të shenjave atëherë mësojani atij shenjat për raste emergjente siç janë zjarri, ikni etj.).
 - Merrni reagime nga nxënësit me vështirësi ne të dëgjuar ne çdo rast të mundshëm si një tregues i nivelit te të kuptuarit të nxënësit.
 - Nëse nxënësi lexon buzë:
 - Duhet të ulet nxënësi afër ligjëruesit. Shikoni direkt nxënësin. Flisni ngadalë, në mënyrë natyrale dhe qartë. Të ngadalësuarit ne të folur do të ishte ndihmëse.
 - Mos i ekzagjeroni lëvizjet e buzëve apo mos bërtisni.
 - Nëse keni mustaqe, mbani ato të mjaft të shkurtuara.
 - Kur të shkruhen materialet për nxënësit me Vështirësi në të dëgjuar:
 - Zbërtheni fjalitë e gjata.
 - Reduktoni ngarkesën e fjalëve të vështira. Mbani në formë të thjeshtë shprehjet për shkaktarët dhe efektet.
 - Nëse nuk ekziston asnjë mundësi për të mënjanuar përdorimin e fjalëve të vështira, përfshini një sqarim të shkurtët në kllapa, megjithatë përpuni ti bëni sa me të shkurtra sqarimet në kllapa.
 - Nëse duhet të mësohet një fjalë e rëndësishme themelore apo teknike.
 - Bëni të qartë në mënyrë absolute domethënie dhe zbatimin.
 - Përdorni kontekstin si një ndihmë memorizuese.
 - Për një term të ri, përsëritni fjalën disa here në varësi të kontekstit.

Vegla 6. Modifikimet për mësimdhënien e nxënësve të cilët janë të verbër apo me vështirësi ne të pamur

Shumica e personave me vështirësi ne të pamur nuk janë të verbër, kështu qe zakonisht mësimdhënësi do të ketë nxënës të cilët kanë të pamur të dobët për të cilët kanë nevojë për disa modifikime në materialin e kursit dhe në mënyrat se si prezantohen detyrat nëse donë qe nxënësit të mësojnë në mënyrë të suksesshme.

Ekziston një mundësi e madhe për pajisje të teknologjisë së lartë për nxënësit me vështirësi ne të pamur, shumica e të cilave nuk është në dispozicion në Kosovë për momentin por do të jetë në dispozicion ne të ardhmen. Pasi qe këto pajisje janë shumë të dobishme, shumica e nxënësve me vështirësi ne të pamur mund të mësojnë në mënyrë të suksesshme me më pak ndihma dhe zbatime teknike.

Braille përdoret nga një numër i vogël i personave të verbër. Nxënësit e verbër dhe ata të cilët nuk kanë të pamur të mjaftueshëm për të lexuar materialet e printuara mësojnë në Brille dhe të gjitha materialet me shkrim të krijuara për ta apo nga ata është në nivelin e mesëm Braille.

Është një sistem i pikëve të ngritura i cili lexohet me prekje. Është e përshtatshme për rrethanat ne të cilat informatat nuk vjetrohen shpejt apo kur informata duhet rishikuar apo memorizuar. Kjo krijohet ose nga korniza e dorës apo përdorimi i stampës.

Teksti mund të konvertohet në Braille dhe materiali i kursit mund të krijohet në Braille nëse është e nevojshme. Është e rëndësishme qe mësimdhënësit të dinë se nëse ata përgatisin një tekst i cili duhet të konvertohet në Braille atëherë ata duhet të:

- Largojnë kolonat dhe në vend të tyre të qesin tekstin në paragrafë.
- Sigurohen se teksti është i barazuar majtas.
- Përshkruajnë diagramet.
- Përdorin tastin tab për të kaluar në kryeradhë nën titujt me një nivel hapësire ndërsa titujt me nivel prej 2 hapësirash.
- Mënjanojnë bullet points pasi qe nuk janë ekuivalente me Braille.

Një kompjuter standard mund të adaptohet duke i shtuar lexuesin e ekranit, e cila i mundëson kompjuterit të 'flas'. Lexuesi i ekranit do të flas tekstin të cilin e gjen dhe nëpër të cilin përdoruesi kalon përmes menyë, kutitë e dialogut, fushat edituese dhe kështu me radhë. Kompjuteri kontrollohet nga tastiera standarde duke përdorur kombinimet e tasteve të quajtura shkurtesa të tastiera në vend të mausit. Disa persona përdorin ekranin Braille i cili ofron informacione në ekran me prekje të ekranit, i cili gjendet nën tastierë.

Shumë persona dëshirojnë të marrin informata audio, kështu qe mësimdhënësi duhet të kontrolloj se a kanë nevojë ata ti marrin informatat ne një CD. Personat me vështirësi në mësimnxënie gjithashtu ju duket më i lehtë përdorimi i audio kopjeve për tu ndihmuar atyre të kuptojnë informacionet. Nxënësve mund tu jepen kopje elektronike të materialit të cilit ata mund të ja rrisin fontin për të përmbushur nevojat e tyre në kompjuter.

Për shumicën e nxënësve me vështirësi ne të pamur madhësia e shkronjave (e njohur si madhësi kyçe) është shumë e rëndësishme. Rekomandohet madhësia e shkronjave 14 në Arial bold apo Verdana bold. Përdorni minimum madhësinë e shkronjave 14 për tekst dhe madhësi me të madhe të shkronjave për tituj. Pyetni nxënësit se cila madhësi ju përshtatet atyre me së shumti – shumica personave me vështirësi ne të pamur preferojnë madhësinë e shkronjave midis 16 dhe 22. Nuk është ndoshta reale qe të printohen dokumentet e gjata me madhësi shkronjash me të mëdha se 18, kështu qe ju doni ta konsideroni krijimin e një audion versioni në vend të saj.

Për dokumentet shumë të mëdha, mund të jetë e pranueshme të printohet një përmbledhje e informacioneve me madhësi të madhe shkronjash. Përndryshe një version i printuar me madhësi të madhe shkronjash i krejt dokumentit do të zinte me qindra faqe. Është më vështirë të lexohet një material me shkronja tepër të mëdha dhe kërkon shumë përpjekje. Nxënësit të cilët përdorin i tekstin e printuar me madhësi të madhe shkronjash do të kenë më shumë kohë për ta lexuar se sa shokët e tyre të klasës.

Sa i më i madh të jetë[kontrasti midis prapavijë dhe tekstit aq më i lexueshëm do të jetë teksti.

Teksti me ngjyrë të zezë në prapavi me ngjyrë të verdhë apo bardhë ofron kontrastin me të mirë. Blloqet e shkronjave të mëdha, të nënvizuara apo teksti italic do të jetë më i vështirë për tu lexuar. Nënvizimi i tekstit apo përdorimi i italic gjithmonë duhet mënjanuar dhe duhet të përdoret një alternativë apo metodë tjetër.

Lexusit me probleme në të pamur shumë lehtë mund të lexojnë gabimisht numrat 3, 5, 8 dhe 0.

Kështu që më mirë shënohen numrat me fjalë si tre, pesë, tetë apo zero.'

Personat me vështirësi në të pamur kanë madhësinë e të shkruarit me të madhe se sa mesatarja, kështu që leni më shumë hapësirë për shkrim në forma. Nga kjo po ashtu do të përfitojnë personat me kushte të cilat nuk u lejojnë atyre përdorimin e duarve, siç janë personat e sëmurë me artritis. Do të ishte e dobishme përdorimi i rreshtave të gjerë apo katrorëve.

Do të ishte e dobishme nëse karakteristikat e përsëritura, siç janë titujt dhe numrat e faqeve në të njëjtin vend.

Listat dhe rregullat e përmbajtjes për të ndarë seksionet e ndryshme janë po ashtu të dobishme. Leni një hapësirë midis paragrafëve pasi që ndarja e tekstit i jep syrit një pushim dhe bën me të lehtë leximin. Përdorni linjat horizontale për të ndihmuar të lexuarit e tabelave, por sigurohuni që është një hapësirë e qartë rreshtave dhe tekstit.

Letra me shkëlqim apo letra e hollë e bën të vështirë leximin e tekstit. Tentohet përdorimi i pajisje të rritjes së madhësisë së printimit duhet të krijoj një printim të madhësisë së madhe nga dokumentet e tyre origjinale por kjo mund të ndërroj tekstin, duke e bërë të vështirë të lexohet. Është shumë më mirë të printohen origjinalet kur do që keni nevojë për to.

Vegla 7. Modifikimet për mësimdhënien e nxënësve me çrregullime të spektrit të autizmit

Personat me sindromën Asperger kanë aftësi intelektuale mesatare apo mbi mesatare. Ata shpesh kanë një memorie jashtëzakonisht të kirë për faktet dhe

interesat e tyre të favorizuar, të cilat mund të përbëjnë një obsesion. Nëse ata gjejnë një profil profesional i cili ju përshtatet interesimit të tyre atëherë ata mund të jenë punëtor jashtëzakonisht efektiv. Prandaj, problemet qenësore shoqërore dhe në komunikim të personave me sindromën Asperger krijojnë sfida për ofruesit e AAP. Problemet e përbashkëta shoqërore dhe në komunikim të cilat ndikojnë tek njerëzit me sindromën Asperger përfshijnë:

Vështirësi në zhvillimin e bisedës së dy anshme

Pa aftësi për të kuptuar udhëzimet verbale

- Vështirësi në punën me të tjerët.
- Nevoja për një rutinë të strukturuar. Individit mund të hidhërohet shumë nga ndryshimet në rutinë
- Problemet me kuptimin e emocioneve të të tjerëve dhe si rezultat reagimi i pa përshtatshëm.
- Çështjet me përpunim të ndjesive mund ta bëjnë personin të reagoj në një mënyrë të pa zakonshme me pamje, zëra, erëra dhe shije të ndryshme.
- Sjellje e përsëritshme dhe obsesive siç janë lëkundjet para dhe prapa, kapja e lëkurës dhe përplasia e duarve .

Disa nga këto simptoma mund të shkaktojnë keqkuptim dhe ta bëjnë të vështirë funksionimin në shkollë apo punë të personit me sindromën në fjalë. Prandaj, është e mundshme që nxënësit me sindromën Asperger të kenë suksese në programet dhe punësim në AAP.

Nxënësit me sindromën Asperger mund të ketë nevojë për

- Udhëzime të qarta dhe të qëndrueshme në lidhje sjelljen e pranueshme dhe atë të pa pranueshme;
- Dalje për pushim nga klasa apo vendi i punës për tu freskuar nëse ata janë të tejet stimuluar apo të mbingarkuar nga personat apo aktivitetet tjera;
- Detyrat të shndërrohen në hapa të vegjël;
- Një rutinë e strukturuar e cila është e njohur për ata me ndryshimet e sinjalizuara mirë paraprakisht;
- Punë vetjake në vend të punës në çifte apo në një ekip;
- Udhëzime me shkrim në vend të atyre me gojë;
- Udhëzime të qarta për të ndaluar bisedat e vazhdueshme në lidhje me temat e tyre të preferuara.

- Të kuptojnë nga nxënësit dhe shokët e klasës të cilët kanë nevojë të dinë pse nxënësi po sillet në mënyra të jo zakonshme dhe se si mund ta ndihmojnë atë për të mënjanuar vështirësitë shtesë.

Vegla 8. Modifikimet për mësimdhënien e nxënësve me vështirësi emocionale dhe në sjellje

Ne të kaluarën nxënësit me vështirësi emocionale dhe në sjellje shpesh e kanë braktisur shkollën para fazës së mesme të lartë, por ne të ardhmen ata do të marrin pjesë në AAP.

Evidenca e vështirësive të rëndësishme emocionale dhe në sjellje tregohen apo shfaqen përmes:

- Tërheqjes apo sjelljes penguese;
- Jo aftësi e dalluar apo e vazhdueshme për koncentrim;
- Shenja të frustrimit të madh apo shqetësim sa i përket vështirësive në mësimnxënie;
- Vështirësi në krijimin dhe ruajtjen e raporteve me shokët e tyre të klasës apo mësimdhënësit apo ndonjë evidencë tjetër e vonesës së dukshme në zhvillimin e jetës dhe shkathtësive shoqërore.

Nxënësit me vështirësi emocionale dhe në sjellje mund të përfitojnë nga:

- Udhëzime të qarta dhe të qëndrueshme në lidhje me sjelljen e pranueshme dhe atë të pa pranueshme;
- Dalje për pushim nga klasa apo vendi i punës për tu freskuar nëse ata janë të tejet stimuluar apo të mbingarkuar nga personat apo aktivitetet tjera;
- Detyrat të shndërrohen në hapa të vegjël;
- Një rutinë e strukturuar e cila është e njohur për ata;
- Punë vetjake në vend të punës në çifte apo në një ekip;
- Udhëzime me shkrim në vend të atyre me gojë;
- Kuptimi nga mësimdhënësit dhe shokët e klasës të cilët kanë nevojë të dinë pse nxënësi po sillet në mënyra të jo zakonshme dhe se si mund ta ndihmojnë atë për të mënjanuar vështirësitë shtesë;
- Këshillimi apo mbështetja psikologjike.

Vegla 9 Modifikimet për mësimdhënien e nxënësve me aftësi të kufizuara të pa dallueshme

Kur nxënësit janë në gjendje apo sëmundje që shohin më pak, është e dobishme që mësimdhënësit të jenë të vetëdijshëm se çfarë ndikimi ka gjendja apo ilaçet e tyre tek nxënësi dhe duhet të kuptoj se cilët janë hapat e nevojshëm që duhen ndërmarrë për ti mundësuar nxënësit të ketë sukses.

Këto përfshijnë:

- Aranzhimet për nxënësit që të vazhdojnë me disa aspekte të punës së tyre gjatë kohës kur ata nuk janë në gjendje të vijojnë mësimin;
- Aranzhimet për nxënësit që të kompenzojnë elementet e programit në të cilat ata kanë munguar;
- Mundësi që nxënësi të ketë në dispozicion më shumë kohë sesa koha e zakonshme për të përfunduar programin e tyre;
- Aranzhimet për nxënësit që të dalin shpesh jashtë klase apo hapësirës së punës nëse është e nevojshme për arsye mjekësore apo personale;
- Shënjime me ngjyra për nxënësit të cilat janë të verbër në ngjyra;
- Të përcaktohet plan i qartë i veprimit për rastet emergjente, siç janë humbja e vetëdijes, kriza apo reagimet ndaj ilaçeve;
- Udhëzimi në karriere dhe këshillimi për tu mundësuar nxënësve të marrin parasysh vështirësitë e tyre kur të përcaktohen për programet e AAP dhe profesione potenciale pasi që disa të rinj ngurrojnë të pranojnë kufizimet e tyre dhe mund të jenë tejet optimist në lidhje me atë që janë në gjendje ta bëjnë.

SEKSIONI 2: VEGLAT PËR ADAPTIMIN E VLERËSIMIT PËR PËRSHTATJEN E KANDIDATËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE ME NEVOJA TJERA TË VEÇANTA

Nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja të veçanta mund të kenë nevojë për të bërë ndryshime në mënyrën se si mësohen ata. Ata po ashtu mund të kenë nevojë për ndryshime për mënyrën se si vlerësohen ata në mënyrë që ata të demonstrojnë plotësisht njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat me të gjëra.

Termi ndryshim është përdorur për t'ju referuar një ndryshimi se si është prezantuar një vlerësim apo se si përgjigjet pranuesi i vlerësimit. Këto ndryshime nuk ndryshojnë përmbajtjen e asaj që është matur. Në nivelin kombëtar apo regional është e nevojshme posedimi i një liste të ndryshimeve të miratuara zyrtarisht e cila mund të përdoret në kushte specifike.

Vegla 10 Marrja parasysch e ndryshimeve

Nëse një nxënësi i është dashur të bëjë modifikime për mësimdhënie dhe mësimnxënie atëherë ekziston mundësia që të kenë nevojë për të bërë ndryshime në mënyrat se si vlerësohen ata. Kur të merret parasysch ndryshimet pikët kyçe duhet të merren parasysch si janë:

i. Mos supozoni se secili nxënës me aftësi të kufizuara ka nevojë për ndryshime në vlerësim.

ii. Ndryshimet e përdorura në vlerësime duhet të jenë sa më të afërta që ka mundësi me ndryshimet e përdoruar në udhëzime.

iii. Të kuptohet qëllimi i vlerësimit. Përzgjidhni vetë ato ndryshime të cilat nuk e pengojnë qëllimin e vlerësimit. Për shembull, në rast të vlerësimit mat llogaritjet, një kalkulator do të ofronte nxënësit një përparësi të pa drejtë. Prandaj, nëse vlerësimi i matematikës mat aftësitë e zgjidhjes së problemeve, një kalkulator do të ishte i përshtatshëm. Në mënyrë të ngjashme leximi i vlerësimit tek nxënësi nuk do të paraqiste një përparësi të pa drejte vetëm në qoftë se vlerësimi mat aftësitë e të lexuarit.

iv. Të bazohen ndryshimet në nevojat aktuale të nxënësit. Ndryshimet duhet të bazohen në nevojat e nxënësit individual dhe jo të bazohen në kategorinë e aftësive të kufizuara të nxënësit. Përderisa nxënësit me aftësi të njëjta të kufizuara mund të kenë nevojë për ndryshime të njëjta apo të ngjashme, pra kjo nuk është bazë e shëndoshë për marrjen e vendimeve.

v. Nëse është relevante, duhet të merret parasysch përvoja kulturore apo etnike nxënësit. Kur të bëhet sugjerimi për një ndryshim sigurohuni se nxënësi dhe familja e tij apo saj janë në pajtim me atë ndryshim. Kur të punohet me nxënës i cili ka njohuri të kufizuara të gjuhës Shqipe duhet pasur parasysch se a duhet të sqarohet vlerësimi tek nxënësi në gjuhën e tij amtare apo ndonjë mënyrë tjetër komunikimi vetëm nëse është e qartë se nuk mund të veprohet ashtu.

vi. Siguroheni se nxënësit të mos i prezantohet kurrë një ndryshim i panjohur për të gjatë vlerësimit. Preferohet që nxënësi duhet të përdor ndryshimin si pjesë e rregullt e udhëzimit. Në fund, nxënësi duhet të ketë kohë të mjaftueshme për të mësuar dhe praktikuar mundësitë para vlerësimit. Ofroni mundësi praktike për nxënësit.

vii. Planifikoni herët për ndryshime. Filloni të merrni parasysch ndryshimet e vlerësimit shumë kohë para se nxënësi ti përdor ato, kështu që ai apo ajo ka mundësi të mjaftueshme për të mësuar përdorimin e tyre dhe të ndihet rehat me përdorimin e tyre. Përfshini nxënësit në marrjen e vendimeve. Nëse është e mundshme përfshini nxënësit në përcaktimin e një ndryshimi të përshtatshëm. Zbuloni nëse nxënësi e ndjen nevojën për ndryshime apo a dëshiron ta përdor ai apo ajo atë ndryshim.

viii. Kërkoni vetëm ato ndryshime që janë vërtetë të nevojshme. Ndryshimet e tepërta mund ta ngarkojnë nxënësin dhe do të dëshmojnë si të dëmshme. Kur të sugjerohet më shumë se një ndryshim, sigurohuni se ndryshimet janë të përshtatshme (psh. Mos ti ndërhyjnë njëri tjetrit apo të shkaktojnë një ngarkesë të pa nevojshme tek nxënësit).

ix. Përcaktoni se ndryshimi i përzgjedhur ka nevojë për ndryshime tjera. Disa ndryshime siç janë leximi me zë të lartë mund të dëshmojnë si penguese për nxënësit e tjerë, dhe prandaj mund të kërkojnë një ndryshim ambientit.

x. Mbani mend se ndryshimet në kryerjen e vlerësimeve nuk do ta eliminojnë frustrimin për nxënësit. Ndryshimi i lejon nxënësit të demonstrojnë çka din apo çka mund të bëjnë ai apo ajo. Ato janë të përcaktuara për të përmbushur nevojat e nxënësve me nevojat që kanë të bëjnë me aftësitë e kufizuara, jo ti japin dikujt përparësi të pa drejtë. Prandaj, ndryshimet nuk garantojnë një notë të mirë për nxënësit apo ulin frikën nga vlerësimi apo ndonjë reagim tjetër emocional në situatën e vlerësimit. Ndryshimet kanë synim të barazojnë fushën e lojës.

Vegla 11. Racionalja për përshtatje në vlerësim

- Secila përshtatje në vlerësim ofrohet për një arsye të veçantë në lidhje me kandidatin me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tjera të veçanta.

1 Kohëzgjatja: ndryshimet në kohëzgjatje të vlerësimit.

Arsyet

Ofrimi i kohës shtesë për të lexuar tekstin, ta shkruajnë në Braille ose ta lexojnë tekstin. Braille dhe teksti i zmadhuar kanë nevojë për më shumë kohë pasi që lexuesi nuk mund ta skanojë tekstin.

Ofrimi i kohës shtesë për të shkruar përgjigjet për nxënësit të cilët kanë vështirësi në mësim për shkak të vështirësive fizike apo të koordinimit apo të vështirësive në të pamur.

Ofrimi i kohës shtesë për përdorimin e pajisjeve të caktuara siç janë korniza e dorës Braille e cila është me ngadalshme se shkrimi apo shtypja.

2 Orari: kur mund të zhvillohet vlerësimi.

Arsyet

Koordinimi i vlerësimit me efektet e ilaçeve. Mundësia e lodhjes së shpejtë për shkak të aftësive të kufizuara fizike në mënyrë që ta japin maksimumin e tyre.

3 Suazat: ndryshimet në vendin ku bëhet vlerësimi.

Arsyet

Tu lejojnë vlerësimin në një vend tjetër nxënësve të cilët nuk mund të venë qasje në ndërtesat e caktuara apo pjesë të ndërtesave.

Tu mundësojnë kolegëve të tyre koncentrim në punën e tyre të cilët mund të pengohen nga ndryshimet siç janë lexuesi, pajisja Braille, softueri apo shënjeshti i aktivizuar i fjalëve.

4 Prezantimi: ndryshimet se si i jepet vlerësimi nxënësit.

Arsyet

Mbështet nxënësit me vështirësi në të pamur i cili mund të ketë materialin vlerësimit të prezantuar në Braille apo skript të zmadhuar.

Mbështet nxënësit me vështirësi në lexim apo kuptim të drejtimeve pasi që ato mund të lexohen apo shënohen tek ata.

5 Përgjigja: ndryshimet se si nxënësi përgjigjet në një vlerësim.

Arsyet

Përmbush nevojat në lidhje me aftësitë e kufizuara fizike dhe të prekurit të cilat e kufizojnë aftësinë e nxënësit për tu përgjigjur, për shembull një kandidat mund të jep përgjigje me gojë në vend të asaj me shkrim. Ndihmon nxënësit me probleme mbajtje mend, radhitje, drejtimi, barazimi, organizimi, dhe probleme tjera të cilat mund të pengojnë performancën e suksesshme në vlerësime.

Vegla 12 Forma e planifikimit

Krijimi i përshtatjeve për kandidatët me aftësi të kufizuara apo me nevoja të veçanta

Emri i kandidatit.....

Data e vlerësimit.....

Përshtatja	Pranueshmëria	Të nevojshme për këtë kandidat (Ju lutem shënoni)	Personi përgjegjës për aranzhimin e të dhënave të nevojshme
Përgatitje shtesë të pyetjeve apo detyrave	Vështirësi në të pamur vështirësi në të dëgjuar Disleksi		
Përshtatje alternative apo larg qendrës	Aftësi të kufizuara fizike Shëndet të dobët fizik apo mendor		
Pajisje zmadhimi të zërit	Vështirësi në të dëgjuar		
Pyetje apo udhëzime Braille	I verbër		
Pajisje shtypi Braille	I verbër		
Emërim ngjyrash	I verbër në ngjyra		
Mbulesa të ngjyrosura	Disleksi		
Kohë shtesë deri në maksimum 25% (NB për shumë kandidatë një tolerancë siç është 10% do të ishte e përshtatshme)	Aftësi të lehta të kufizuara fizike, vështirësi në të dëgjuar apo të pamur Disleksi		
Kohë shtesë mbi 25%	Më shumë vështirësi të lehta në të pamur, dëgjuar apo fizike Aftësi të kufizuara të shumëfishta		
Ndihmë për shkurtpamësi	Vështirësi në të pamur		
Fletë e modifikuar pyetjesh të zmadhuara apo instruksione në formatin A4 deri në A3	Vështirësi në të pamur		

Lexues / kompjuter lexues	Disleksi Vështirësi në të pamur Vështirësi e lehtë intelektuale		
Pajisje regjistruese (kasetë apo CD)	Kandidatët me mangësi të lehta kontrolli të lëvizjeve, të cilët nuk janë në gjendje të shkruajnë përgjigjet e tyre dhe janë në gjendje të incizojnë ato		
Jo mbikëqyrja e ndarë	Kandidati ka nevojë për lexues, një shkruar apo pajisje e cila është e zhurmshme dhe penguese për kandidatët tjerë. Sindromi Asperger		
Shkruesit/Kompjuter me aktivizim zëri	Kandidatët me mangësi të lehta kontrolli të lëvizjeve, të cilët nuk janë në gjendje të shkruajnë përgjigjet e tyre dhe janë në gjendje të incizojnë ato		
Asistent praktik për mbështetje të nevojave praktike	Kandidat me aftësi të kufizuara fizike		
Interpretues shenjash	I/e shurdhër		
Pauza të mbikëqyrura për pushim	Aftësi të kufizuara mjekësore, fizike, psikologjike		
Diagramet e prekshme	Vështirësi në të pamur		
Transkriptë e shkrimit me dorë për shënues për të qenë në gjendje të lexoj përgjigjen e kandidatit	Skripta Braille		

Transkripta e regjistrimit për shënues për të pasur një dokument të shkruar për shënim	Skripta Braille		
Dokument pyetjesh i pa definuar A3	Vështirësi në të pamur		
Kompjuter me aktivizim zëri	Vështirësi në të pamur Aftësi të kufizuara fizike		
Përpunimi i fjalëve	Aftësi të kufizuara fizike		



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

Implementuar nga:



Për më shumë informata, ju lutem na kontaktoni:

Qendra e Studentëve
Rr. Agim Ramadani p.n.
Prishtinë, 10000, Kosovë

+381 (0) 38 212 595

+381 (0) 38 213 433

www.akk-ks.net